



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 01-060/04-0029626/25
Data 23.07.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

THËRRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 31.07.2025, (ditë e enjte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë: REND DITE


1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2025, me Nr.04-052/01-0026961/25, të datës 09.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, me Nr.04-47-1123/1, i datës 26.06.2025, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, me Nr. 04-052/01-0026963/25, i datës 09.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
6. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, e datës 06.06.2022, për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-110/05-0029514/25, e datës 22.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
7. Propozim-vendim për Themelimin e Poliklinikës Specialistikë në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-351/01-0026564/25, të datës 10.07.2025, (Raporton U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, **z. Ilir Havolli**);
8. Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar, Nr. 09-052/01-0026407/25, i datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025, me Nr.02-052/01-0027799/25, i datës 11.07.2025, Raporton drejtori i DSHP-së **z. Alban Shala**);
9. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.



KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i **MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ**,
i datës **30.06.2025**, ora **11:30**

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2026-2028, dhe Raporti mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, me Nr.04-052/01-0022314/25, të datës 12.06.2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, z. **Ismet Aliu**);
5. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu: I nderuar kryetari i komunës, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, kjo mbledhje është thirrur për datën 27.06.2025, në ora 10:00, nuk është mbajtur për shkak të kuorumit, dhe është shty për sot, për datë 30.06.2025 në ora 11:30, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 30 anëtar, mungon me arsye Arjeta Rama.

-Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, me qenë se për sot është paralajmërua privatizimi i Klubit KF. Drenica nga ana e u.d. të kryetarit z. Nura, Kisha kërkuar me hy si pikë në rendit të ditës, Një lloje Informate për këtë privatizim të Klubit KF. Drenica? Sepse kur kam kërkuar qasje në dokumente zyrtare, po e arsyetoj kërkesën; për ti parë pagat muftë që i marrin disa individ në këtë klub, z. Nura me thoshte nuk është në kompetencën e komunës, ndërkohë tash e ka marrë bajrakun për me privatizuar klubin dhe do duhej me na tregua në çfarë cilësie ka hy në këtë lloje privatizimi cili është roli i ti si kryetar? Është me rendësi me ditë çfarë privatizohet në klub a përfshihen edhe asetet e klubit, p.sh. nëse përfshihet edhe stadiumi a është në kundërshtim me Ligjin për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, i cili që përveç që e ndalon bartjen e pronës publike të personat e tretë, ndalohet edhe dhënien e pronës publike në shfrytëzim prej ditës kur presidentja i ka shpallur zgjedhjet. Nuk jemi kundër investimeve, përkundrazi i ftojme dhe i mirëpresim, po ajo çka është shumë me rendësi me ditë a përfshin kjo marrëveshje objekte banesore që po flitet që stadiumi ka me u kthyer në objekte banesore, do duhej transparencë, sepse mungesa e transparencës ka bërë që me menduar njerëzit edhe për veturën në llastik që i ka marrë dikush, pra kur je jo transparent tani krijohen shumë aludime. Tash dorën në zemër ajo çka e dimë na klubi është i falimentuar prej menaxhimit të dobët, ka lojtar 3-4 muaj nuk kanë marrë paga, edhe ma e keqja ata që kanë punuar aty në klub minx s'po presin me u privatizuar klubi, jo për të mirën e klubit, po mi marrë pagat që klubi jave ka borq, pra a mundem mi pas disa detaje të këtij privatizimi? Sepse na e dimë këtij investitori nuk ju ka pranuar shtatorja e Skënderbeut në Skenderaj që ju ka ofruar komunës si dhuratë, dhe është detyruar me vendosur sipër një objekti banesor, tash po

flitet për prona, z. Nura je i obliguar këtij kuvendi dhe gjithë qytetarëve me ju dhënë një sqarim për privatizimin e KF. Drenica, e jo me shkua me një marrëveshje krejt në terr, pa as një lloje transparence. Pra kërkoj me hy si pikë shtesë Informate nga kryetari lidhje me privatizimin e Klubit KF. Drenica.

Abdulla Gashi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, Ne lista IDEAL, e kemi një propozim për pikë shtesë për këtë rend dite; Propozim për heqjen e taksës së regjistrimit të automjeteve për familjet e dëshmorëve, veteranëve të UÇK-së, në komunën e Skenderajt? Arsyetim; familjet e dëshmorëve, veteranëve të UÇK-së, përfaqësojnë një shtyllë themelore të lirisë të shtete ndërtimit tonë, ata kanë dhënë sakrificë të lartë për çlirimin dhe pavarësinë e Rep. Kosovës, ky institucion lokal ka detyrim moral dhe institucional të tregojë kujdes për përkrahje të vazhdueshme ndaj këtyre kategorive të veçanta, kjo heqje e taksës komunale për automjete simbolizon respektin dhe vlerësimin e komunës ndaj këtyre kategorive. Të dashur asamblist kërkoj nga ana juaj që të votoni që kjo pikë të futet në rend dite.

Kryesuesja; Dikush tjetër, nëse nuk ka, fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, po i japi disa sqarime për çështjen që u shtrua këtu me pretekstin pikë e rendit ditës. Do të jeni të informuar për gjithçka që rrjedhin, dhe derisa kërkohet një çështje duhet arsyetim ligjorë, e para duhet me njoh statutin e OJQ-së çka është, duhet me pas parasysh ligjin e sportit UA, përkatëse të OJQ-ve që i kanë. Nuk është klubi i falimentuar është e pa vërtetë, ne e kemi bërë një hap të privatizimit, kemi investitor të interesuar, që është një zgjidhje afatgjate e këtij problemi, sepse ju e dini për KF. Drenica kemi pas raste kur këtu kemi kërkuar përkrahje për subvencionime në këtë kuvend kur u kanë gjendja e vështirë. Sporti është shndërruar në një farë lloj biznesi ose industri biznesorë dhe në raste të tilla e vetmja zgjidhje ka qenë të shndërroje klubin nga statusi që e ka në status privat, dhe privatizimi do të shkoj do të shkoj në procedura ligjore siç e parasheh ligji. Marrëveshja fillestare do të miratohet këtu në kuvend dhe do të jepen arsyetimet si akte fillestar. Procedura e hapjes së pronës kur privatizohet do të shkon sipas legjislacionit në fuqi, sipas Hartës zonale që është miratua këtu në këtë kuvend, dhe asaj detyrohemi ti nënshtrohemi si kryetar i komunës dhe gjithçka do të jetë transparente. Investitori i ka marr përsipër obligimet me ndërtua stadiumin, fusha sportive e çështjet tjera në përputhje me Hartën zonale, kjo marrëveshje sigurisht do të vjen pas zgjedhjeve sepse edhe na e kemi zyrtarisht shkresën nga MAPL-ja, sepse kjo marrëveshje përcakton dhënien e pronës që janë të destinuar për fusha sportive. Klubi sipas informatave i ka diku 400mijë € borqe, dhe nuk është e vërtetë që i marrin ka 2-3 paga punëtorët, dhe investitorë duhet me i pagua 400mijë €, në starte që figurojnë në emër të klubit, në momentin që nënshkruhet marrëveshja, marrëveshja bëhet publike, po implementimi i saj do të filloj pas zgjedhjeve lokale të 12 dhjetorit.

Sa i përket kërkesës se dytë për pikë shtesë nga Abdulla Gashi, unë kam pas kërkesë edhe prej organizatës, na kategoritë e luftës i kemi lirua nga gjitha taksat administrative, prej taksave për automjete janë të liruara invalidët dhe personat me aftësi të kufizuar, familjet e dëshmorëve është mirë me i lirua për veteran duhet me diskutua sepse ajo taks krijon të hyra për komunën që është e nevojshme të ekzistoj.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Hysni Mehani-LVV: Çka e dëgjova z.Nura kjo është logjika e dadës Razë që është bërë këtu në Drenicë, dada Razë në Drenicë i fiton zgjedhjet, ti je në suaza logjike të dadës Razë që gjithqysh i fiton zgjedhjet dhe je tu e bërë një farsë elektorale prej krejt asaj çka the, d.m.th ti sot po e bënë solemnisht një punë që as një bazë ligjore nuk e ka, as nuk mundesh me ja dhënë pronën as nuk mundesh me ndërmarr as një hapë, krejt çka po e bënë tash farsa e dadës Razë për zgjedhje lokale edhe krejt ato çka i the ti Hartën zonale e kam votuar kundër, kundër keni qenë edhe ju si parti

politike, edhe ti e vërtetove që në stadium keni me ndërtua banesa, qatë çka unë i kam pas detyrimit ti i vërtetove këtu. Edhe e vërtetove që klubi është i falimentuar së i ka 400 mijë borqe, të cilat si komunë nuk keni qysh me ja rimbursua atij, edhe këtu po na prezanton si sukses, pra është farsë elektorale e dadës Razë me kundërshtim me ligjin.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Selim Tahiri-PDK: Fjala përshëndetëse, unë gjithmonë kam qenë për privatizim të klubit sepse është barrë e madhe për komunën e aq me pak kur klubi futet në superligë që ka shpenzime shumë të mëdha, që shumë komuna tjera nuk kanë mundur me majtë klubet në superligë për shkak të shpenzimeve të mëdha pa pas një partner ose me privatizua. Kolegu Hysnia ka drejtë plotësisht me kërkuar informacion shtesë, po ajo çka nuk me pëlqen po vjen po fole me fjalë të kafeve, si ndërtimi i banesave në stadium, vetura në llastik, dhe tu kisha lutë mos me prezantua këtu këto fjalë, me keqpërdor kuvendin.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Abdulla Gashi-IDEAL: Sa i përket propozimit të listës Ideal, për futjen në rend dite, Propozim për heqjen e taksës së regjistrimit të automjeteve për familjet e dëshmorëve, veteranëve të UÇK-së, në komunën e Skenderajt, ne jemi bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, rregullore komunale, nuk është një barrë e madhe për heqjen e kësaj takse për këto kategori, është momenti i duhur për futjen në rend dite, është obligim për kuvendin komunal për heqjen e kësaj takse, nëse nuk hynë kjo pikë në rend dite, ne jemi të detyruar me lëshua seancën.

Hysni Mehani-LVV: Nuk jam kundër privatizimit, veç jam për me pa substancat qysh po shkon privatizimi, dhe e kundërshtoj mungesën e transparencës në këtë rast, dhe krejt mënyrën qysh po shkon ky proces.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Nuk mundesh me pa substanca ku ende nuk ka diçka konkrete, ku deri tash kemi qenë në proces të negocimit duke ju nënshtrua gjithmonë bazës ligjore, interesin e komunës po edhe interesin publik dhe gjithçka ka me qenë transparent dhe në kornizat ligjore në legjislaturën e ardhshme. Po nëse mendon me kthye prapë publik prapë kthehet, vetëm ja kthen mjetet investive investitorit, Harta zonale është e certifikuar dha asaj i nënshtrohem. Investitori ka kërkuar pronën në shfrytëzim, për ndërtimin e stadiumit, fushave sportive. Sa i përket krehëses së z. Gashi për futje në rend dite propozimin që e prezantoj, nuk po e kontestoj po është procedurë sepse duhet me u ndryshua rregullorja për taksë e duhet me kalua në diskutim publik 1 muaj ditë për me ndryshua plotësua e duhet me respektua këtë afat sepse ministria na kthen të kundërligjshëm, e nuk po e kontestojmë atë.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet ky debat, shkojmë në votim për futje në rend dite, propozimin e Hysni Mehanit, Konstatohet me (13) vota për, (17) kundër dhe (0) abstenim, nuk futet në rend dite një, Informate nga Kryetari për privatizimi të Klubit KF. Drenica?

Shkojmë në votim për futje në rend dite propozimin, e Abdulla Gashit, Konstatohet me (13) vota për, (12) kundër dhe (5) abstenim, nuk futet në rend dite Propozim për heqjen e taksës së regjistrimit të automjeteve për familjet e dëshmorëve, veteranëve të UÇK-së, në komunën e Skenderajt,

Anëtarët e listës, IDEAL, LVV, dhe NSD, e lëshojnë sallën, në sallë janë 17 anëtar,

Shkojmë në votim për rend dite; Konstatohet me (17) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Konstatohet me (17) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2026-2028, dhe Raporti mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, me Nr.04-052/01-0022314/25, të datës 12.06.2025, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2026-2028, është një dokument i hartuar nga ekzekutivi i komunës, i udhëhequr nga kryetari, bazën ligjore e ka në Ligjin për menaxhim e financave publike dhe përgjithësisë, po hapi fillestar është të Qarkorja buxhetore 2026/01 të cilën e kemi pranuar në afate ligjor që janë shqyrtuar të gjitha kërkesat buxhetore të gjitha drejtorive. Në këtë qarkore kemi përfituar grand për financimin e komunës si; Grandi i përgjithshëm, grand për shëndetësi, grand për arsim, grand për qendrës rezidencialë, dhe grand nga të hyrat vetanake të cilën komuna janë të obliguar me implementua. KAB-i është reflektuar, ndikuar edhe nga regjistrimi i fundit i popullsisë që ka hy në fuqi edhe neve si komunë na ka ndëshkuar në uljen e grandit të përgjithshëm për arsye komuna jonë me LVL dhe Ligjin për paga përfiton grandin e njëjtë në vitin aktual sepse ligji nuk lejon të kemi një buxhet me të vogël në vitin e ardhshëm, ndërsa vitet tjera sigurisht do të rezultojë sipas regjistrimit të popullsisë. Nëse e shikojmë si total buxheti për vitin 2026 do të jetë me i lartë prej 1.84%. është me rendësi të ceket së në kategorinë e pagave, ligji i pagave do të ketë ndikim në zvogëlimin e koeficienteve për të gjithë zyrtaret me përjashtim të shërbyesve shëndetësor dhe të arsimit, për arsye së komuna jonë ka kaluar në rendin e 4. Sa i përket dëgjimeve buxhetore, i kemi organizua neper gjitha BL, i kemi marr propozimet dhe jemi mundua me inkorporua ne projektet kapitale për planit tre vjeçare, kjo ishte në pika të shkurta raportimi i KAB-it, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, në KPF, i kam shtrua dy pyetje, njëren është përgjigj drejtori, pyetjen tjetër e kam për DSHP, drejtor a është parapa transport për personat me aftësi të kufizuar në komunën ton, disa here e kam paraqitë këtë kërkesë?

Besart Rrecaj-PDK: Fjala përshëndetëse, e kam një pyetje konkrete për drejtorin e urbanizmit,, konkretisht në dy vitet e ardhshme a është paraparë trotuar në Rr. Sadik Haziri, prej lagjes Rrecaj deri te vendi i quajtur Përroi i keq, ku lidhet rruga Mitrovicë-Pejë? E kam bë disa herë këtë kërkesë, banoret janë të zhgënjyer, a do të bëhet ky trotuar, dhe nëse nuk do të behet do të jetë një zhgënjim i madh i atyre banorëve, sepse është një neglizhencë sepse janë votues të PDK, dhe personalisht vota të mia.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Drejtorit i DSHP-së, Alban Shala: Fjala përshëndetëse, është me së e arsyeshme kërkesa Mentor për një transport për personat me aftësi të kufizuar po për arsye buxhetore nuk kemi arrit me planifikua diçka për vitin 2026, një projekt për transportin për këto kategori, mbesim për vitet e ardhshme.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Besart sa i përket trotuarit qe e përmende, e dimë që është në gjendje shume të keqe ajo pjesë, për shkak të lëvizjeve, për këtë vite është problem, vitin tjetër besoj që kryhet.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Besart Rrecaj-PDK: Drejtor ajo rrugë është jashtëzakonisht e rrezikshme sidomos nga pjesa e prroitë të keq, dhe me vendim të këshillit për siguri në bashkësi janë tërheq edhe pengesat, nëse larg qoftë shkelet ndonjë kalimtar, moralisht përgjegjësi morale kemi edhe na.

Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Sa i përket kërkesës së Besartit, me të vërtetë është shumë e nevojshme, dhe para do dite kam bisedua me drejtorin qysh me fillua sa ma shpejt në atë rrugë, po mundësi buxhetore nuk ka, për arsye së arsimit na ka marr afër 1 milion €, dhe në proces janë edhe 1 milion e 200 mijë€ që i kanë marrë në projektet kapitale, kemi me shikua me drejtorin dhe me bërë çmos me fillua sivjet. Çështja e pikës që e ngritën opozita, atë pik duhet me sjell në procedurë të rregullt sepse është procedurë për heqjen e tarifës. Dhe pyetjet që i kanë këtu mos të barten në seancën tjetër.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet ky debat, shkojmë në votim, Konstatohet me (17) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2026-2028, dhe Raporti mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, me Nr.04-052/01-0022314/25, të datës 12.06.2025.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës,

Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, kërkoj nga sekretaria që pyetjet e Afrim Kabashit, Hysni Mehanit dhe Abdulla Gashit mos të barten në seancën e radhës, me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ



№ 04-052/01-0026961/25
No
Data 09.07.2025
Data



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

RAPORTI FINANCIAR
GJASHTËMUJOR
Janar – Qershor 2025

Korrik 2025

Permbajtja:

Raporti Financiar Gjashtëmujor Janar-Qershor 2025	3
1. Kërkesat për raportim	3
2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE	3
3. Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit 2025 TABELA Nr. 1	4
4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-QERSHOR 2025	5
5. SHPENZIMET BUXHETORE	7
Tabela nr. 4 Projektet kapitale të realizuara Janar-qershor 2025	10

Raporti Financiar Gjashtëmuor Janar-Qershor 2025

1. Kërkesat për raportim

Raporti Financiar gjashtëmuor Komunal për periudhën Janar – Qershor 2025, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 45.4 dhe 46.2 të Ligjit Nr.03/L-048“Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Raporti Financiar Komunal ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Periudha e raportimit karakterizohet me faktin se:

- Është përfunduar dhe aprovuar Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe e kemi dorëzuar në afatin ligjor në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferove,
- Janë mbajtur dëgjimet buxhetore me qytetar në lidhje me prioritetet e Qeverisë Lokale për periudhën 2026-2028 dhe
- Është finalizuar bartja e një pjese të THV-ve komunale të pasqepnuara nga viti 2024 për shpenzim në vitin aktual 2025 por do të shpenzohen në pjesën e dytë të vitit sipas vendimit të Kuvendit komunal dhe njëkohsishtë do të raportohen në tremujorin e tretë 2025.

2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”.

Buxheti i aprovuar për vitin 2025 është **19,881,471.00 €** plus të hyrat e bartura shtesë në shumë prej **194,930.63 €** shpërndarë në pesë kategori ekonomike :

Pagat dhe Mëditjet	11,020,774.00
Mallrat dhe Shërbimet	2,938,809.99
Shërbimet Komunale.....	287,300.00
Subvencionet.....	1,177,000.00
Investimet Kapitale.....	4,652,517.64
Gjithsej	20,076,401.63

3. Raporti i Ekzekutimit te Buxhetit 2025 TABELA Nr. 1

TABELA NR 1 RAPORTI I BUXHETIT DHE EKZEKUTIMIT TË TIJ : JANAR- QERSHOR 2025


FONDET BURIMORE	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Shpenzimet (pagesat) 2025	Shpenzimet (pagesat) 2024	% e realizimit 3/2
0	1	2	3	4	5
GRANTI I PERGJITHSHËM	18,172,005.00	18,172,005.00	10,281,504.45	10,231,433.05	56.58
Pagat dhe Shtesat	11,020,774.00	11,020,774.00	5,651,146.90	6,608,795.74	51.28
Mallrat dhe Shërbimet	2,722,807.00	2,722,807.00	1,726,853.34	1,273,134.36	63.42
Shërbimet Komunale	287,300.00	287,300.00	157,419.62	147,578.44	54.79
Subvencionet	1,052,000.00	1,052,000.00	653,441.22	556,140.60	62.11
Shpenzimet Kapitale	3,089,124.00	3,089,124.00	2,092,643.37	1,645,783.91	67.74
Rezerva					
TË HYRAT VETANAKE Aktuale	1,709,466.00	1,709,466.00	544,216.82	441,388.74	31.84
Pagat dhe Shtesat					
Mallrat dhe Shërbimet	124,000.00	124,000.00	81,493.69	18,549.14	65.72
Shërbimet Komunale					-
Subvencionet	95,000.00	95,000.00	66,812.52	60,700.00	-
Shpenzimet Kapitale	1,490,466.00	1,490,466.00	395,910.61	362,139.60	26.56
Rezerva					-
TË HYRAT E BARTURA	-	194,930.63	-	142,775.64	-
Pagat dhe Shtesat					-
Mallrat dhe Shërbimet		92,002.99			-
Shërbimet Komunale					-
Subvencionet		30,000.00		15,780.00	-
Shpenzimet Kapitale		72,927.64		126,995.64	-
DONACIONET	-	-	-	-	
Pagat dhe Shtesat					-
Mallrat dhe Shërbimet					-
Shërbimet Komunale					-
Subvencionet					
Shpenzimet Kapitale					
HUAMARRJA E JASHTME	-	-	-	-	
Pagat dhe Mëditjet					
Mallrat dhe Shërbimet					
Shërbimet Komunale					
Subvencionet					
Shpenzimet Kapitale					
GJITHSEJ K.EKONOMIKE	19,881,471.00	20,076,401.63	10,825,721.27	10,815,597.43	53.92
Pagat dhe Shtesat	11,020,774.00	11,020,774.00	5,651,146.90	6,608,795.74	51.28
Mallrat dhe Shërbimet	2,846,807.00	2,938,809.99	1,808,347.03	1,291,683.50	61.53
Shërbimet Komunale	287,300.00	287,300.00	157,419.62	147,578.44	54.79
Subvencionet	1,147,000.00	1,177,000.00	720,253.74	632,620.60	61.19
Shpenzimet Kapitale	4,579,590.00	4,652,517.64	2,488,553.98	2,134,919.15	53.49

- Përqindja e kategorive ekonomike në pjesëmarrjen e buxhetit aktual Komunal :

Nga të dhënat e buxhetit aktual të planifikuar del se kategoria Paga dhe Shtesa merr pjesë me 54.89 % të buxhetit të përgjithshëm , mallrat dhe shërbimet 14.64 %, komunalit 1.43 %, subvencionet 5.86 % dhe kategoria e projekteve kapitale merr pjesë me 23.17 % .

Sipas tabelës mund të shihet se shpenzimet e përgjithshme për periudhën Janar-Qershor 2025 janë 10,825,721.27 ose 53.92 % të buxhetit aktual.

Grafikisht:



Përqindja e fondeve burimore në pjesëmarrjen e buxhetit Komunal të aprovuar:

- Grandi qeveritarë në vlerë 18,172,005.00 € merr pjesë me 90.51 % të Buxhetit Komunal,
- Të hyrat vetanake Komunale dhe të bartura në vlerë 1,904,396.63 € marrin pjesë me 9.49 %,

4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-QERSHOR 2025

Përveç Grandeve të pranura nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka arkëtuar edhe të hyra vetanake si pjesë financuese e buxhetit Komunal. Ekzistojnë disa lloje kryesore të hyrave vetanake komunale: tatimin në pronë, gjokat e trafikut, taksa administrative për leje ndërtimi, shërbimet e kadastrave, taksa për regjistrimin e automjeteve etj. të cilat përbejnë një përqindje me të madhe për buxhetin e përgjithshëm komunal në krahasim me taksat tjera e që arkëtohen në pajtim me rregulloret komunale.

Të hyrat Janar-Qershor 2025 të arkëtuara kanë arritur në shumën prej 730,708.27 € që përbejnë 42.83 % të planifikimit vjetor, kurse në krahasim me periudhën e njëjte të vitit 2024 janë me të larëta për 6.31% , edhe pse për këtë periudhë ende nuk i kemi pranuar të hyrat indirekte (gjokat për tm2) nga MFP dhe Transferove.

Në detaje tabela vijim:

TABELA NR. 2

PASQYRA

e të hyrave vetanake sipas drejtorive, planifikuar dhe realizuar në periudhën: Janar - Qershor 2025

Nr.	Përshkrimi	Kodi	Planifikimi	Realizimi		% e planit
			2025	2025	2024	5/4
1	2	3	4	5	6	7
I	Administrata dhe Personeli	16323	50,100.00	17,885.69	23,464.04	35.70
1	Çertifikatë lindjeje	50013	2,500.00	945.00	1,494.92	37.80
2	Çertifikatë kurorëzimi	50014	5,500.00	1,359.00	1,852.00	24.71
3	Çertifikatë vdekjeje	50015	2,200.00	1,013.00	678.00	46.05
4	Çertifikatë – vërtetime të tjera ofiqarike	50016	37,000.00	14,205.00	18,493.00	38.39
5	Taksa administrative	50019	2,900.00	243.00	380.00	8.38
6	Sigurimi i automjeteve	50109		120.69	48.60	
7	Shitja e pasurisë komunale	50413			517.52	
II	Inspektimi	16645	9,000.00	3,880.00	6,505.00	43.11
1	Gjobat nga inspektorët komunal	50104	7,500.00	3,200.00	5,975.00	42.67
2	Gjobat mandatore - hudhja e mbeturinave	50114		-	-	
3	Taksa për pranim teknik të lokaleve	50205	1,500.00	680.00	530.00	45.33
III	Buxhet dhe Financë	17523	456,460.00	206,776.29	151,407.91	45.30
1	Tatimi në pronë	40110	344,960.00	152,577.29	101,759.91	44.23
2	Taksa për regjistrimin e automjeteve	50001	110,000.00	53,460.00	47,916.00	48.60
3	Taksat për vërtetime dhe çertifikata tjera	50011	1,500.00	739.00	931.00	49.27
4	Taks Administrative	50019		-	801.00	
IV	Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi	48023	55,000.00	13,900.00	7,275.00	25.27
1	Taksa komunale në biznes	50201	55,000.00	13,900.00	7,275.00	25.27
2	Gjobat e biznesëve nga inspektorët financiarë	50104		-	-	
V	Shërbimet Publike e Mbrojtja Civile	18023	5,500.00	875.00	2,970.00	15.91
1	Taksa për leje parkingu	50008	5,500.00	775.00	2,670.00	14.09
2	Shfrytëzim i pronës publike	50405		100.00	300.00	
VI	Bujqësi dhe Zhvillim Rural	47023	13,550.00	202.00	9,173.05	1.49
1	Nderrimi i destinimit të tokës	50012	150.00	-	-	-
2	Taksa tjera administrative për bujqësi	50016	3,400.00	202.00	173.00	5.94
3	Participimet në bujqësi	50409	10,000.00	-	9,000.05	-
VII	Gjeodezia, Kadastrë dhe Prona	65315	127,923.00	47,407.73	96,516.83	37.06
1	Trashigimia – bartja, regjistrimi i pronës	50011	36,000.00	16,618.00	18,161.00	46.16
2	Taksë për fletë-poseduese dhe kopje plani	50032	12,623.00	3,771.00	7,111.00	29.87
3	Taksa administrative	50019	6,300.00	2,548.00	2,455.00	40.44
4	Renta - shfrytëzimi i pronës publike	50405	30,000.00	4,274.05	8,686.40	14.25
5	Qiraja nga objektet publike	50408	18,000.00	8,649.68	9,739.60	48.05
6	Aktivitetet në terren për matje	50504	25,000.00	10,612.00	18,158.00	42.45
7	Tax ndërrim destinimit të tokës	50012		935.00	32,205.83	
VIII	Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit	66620	631,583.00	317,982.66	287,421.10	50.35
1	Lejet ndërtimore	50009	292,333.00	174,468.58	193,025.38	59.68
2	Taksat administrative	50019	250.00	984.00	1,120.00	393.60
3	Të hyrat nga koncesioni	50417	316,000.00	130,000.00	52,891.60	41.14
4	Takse komunale për leje mjedisi	50045	10,500.00	11,211.73	29,147.96	106.78
5	Legalizimi i Objekteve Ndërtimore	50026	12,500.00	1,318.35	11,236.16	10.55
IX	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	73032	51,500.00	22,710.50	24,153.00	44.10
1	Taksa administrative DSHMS	50019	13,500.00	8,585.00	9,019.00	63.59
2	Participimi - arka	50409	32,000.00	11,605.50	13,139.00	36.27
3	Çertifikatë mjeku	50024	6,000.00	2,520.00	1,995.00	42.00
X	Kultura, Rinia e Sporti	85023	450.00	-	-	-
1	Participimi nga KRS (biblioteka)	50409	450.00	-	-	-
XI	Arsimi – Oerdhja e fëmijëve	92650	55,000.00	34,923.40	28,552.00	63.50
1	Participimi për kujdesin e fëmijëve	50409	55,000.00	34,923.40	28,552.00	63.50
GJITHSEJ TE HYRAT			1,456,066.00	666,543.27	637,437.93	45.78
XII	Të Hyrat tjera - Gjobat nga Trafiku, Gjykata, e tjera		250,100.00	64,165.00	47,205.00	25.66
1	Të hyrat nga gjobat në trafik	50101	180,000.00	52,360.00	35,815.00	29.09
2	Të hyrat nga gjobat e gjykatave	50102	70,000.00	11,805.00	11,390.00	16.86
3	Të hyrat nga Agjensioni pyjor e tjera	50107	100.00	-	-	-
GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE			1,706,166.00	730,708.27	684,642.93	42.83

5. SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet e komunës janë realizuar përmes pesë kategorive ekonomike të parapara me Ligjin e ndarjeve buxhetore për vitin 2025 dhe atë për :

- a. Paga dhe mëditje
- b. Mallra dhe shërbime
- c. Komunali
- d. Subvencione dhe
- e. Kapitale

Në tabelën vijuese kemi paraqitur të dhënat për lëvizjen e të gjitha këtyre kategorive të shpenzimeve për periudhën raportuese Janar-Qershor 2025 duke krahasuar shpenzimet e kësaj periudhe me shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit 2023 dhe vitin 2024.

Sipas tabelës mund të shihet se:

- Masa e përgjithshëm e paguar për paga ka shënuar rritje në krahasim me periudhën e kaluar kohore të vitit dmth janë shpenzuar 51.28 % e fondit aktual. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimet e përgjithshëm komunale për periudhën Janar-Qershor 2025 është 52.25 %. Në shpenzimin e më tepër të kësaj kategorie kanë ndikuar ngritja e koeficientit për vitin aktual që kanë rrjedh nga Ligji i buxhetit 2025.
- Mallrat dhe shërbimet kanë pasur shpenzim prej 61.53 % e fondit aktual kurse pjesëmarrja e tyre në shpenzimet e përgjithshme është 16.72 %
- Shërbimet Komunale pasur shpenzim prej 54.79 %, kurse në shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 1.46 %
- Subvencionet kanë pasur shpenzim prej 61.19 % e fondit aktual, janë subvencionuar kryesisht programet për bujqësi, pagesa të këtij viti për Bashkësinë Islame, bursat për student, klubet sportive, pagesa për fëmijët e porsalindur, në shpenzimet e përgjithshme subvencionet marrin pjesë me 6.66 %
- Shpenzimet kapitale kanë pasur shpenzim prej 53.49 % e fondit aktual, ndërsa në shpenzimet e përgjithshme komunale marrin pjesë me 23.01 %

Në përgjithësi shpenzimet e gjithmbarshme komunale janar-qershor 2024 janë për 30.91 % më të mëdha se ato në vitin 2023.

Për më tepër të dhënat në tabelën nr.3:

Tabela nr. 3 Analitikë e shpenzimit të buxhetit

TABELA NR. 3 Llojet e shpenzimeve sipas kategorive dhe nenkodeve

Nr. R	Kodi Ekonomik - LLOJI I SHPENZIMEVE	Shpenzimi sipas viteve :		
		2023	2024	2025
1	11111 - Paga neto	4,039,307.42	4,032,135.74	4,493,820.35
2	11121 - Tatimi në të ardhurat personale	257,416.44	291,366.52	280,141.80
3	11131 - Kontributi pensional - punëtori	226,691.00	245,000.77	268,980.60
4	11151 - Sindikatat	8,915.24	9,681.44	11,448.84
5	11152 - Odat profesionale	3,718.83	4,895.04	5,605.34
6	11211 - Përvoja e punës		199,611.29	220,231.95
7	11311 - Kontributi pensional - punëdhënësi	226,691.00	245,000.77	268,980.60
8	11411 - Shtesa e veçant për të zgjedhurit		17,777.17	15,039.66
9	11431 - Kujdestaria, puna gjatë natës & puna jashtë orarit të punës		100,786.59	82,077.79
10	11611 - Shtesat tranzitore		6,920.58	4,819.97
11	11900 - Vendimet gjyqësore	11,218.66	1,455,619.83	
	GJITHSEJ PAGAT DHE SHTESAT	4,773,958.59	6,608,795.74	5,651,146.90
1	13140 - Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendi	6,653.00	855.00	
2	13141 - Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	564.80	182.00	2,764.00
3	13142 - Akomodim për udhëtime zyrtare jashtë vendit	2,308.90	2,333.32	78.00
4	13143 - Shpenzimet tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendi	313.00	3,888.90	
5	13310 - Interneti	3,749.14	4,440.00	4,560.00
6	13320 - Telefonia mobile	9,480.67	9,865.44	8,230.70
7	13330 - Shërbimet postare	239.70	4,815.31	326.40
8	13410 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit		8,500.00	9,096.00
9	13440 - Shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale	2,750.00	10,862.09	6,548.54
10	13445 - Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual		3,929.46	4,655.97
11	13450 - Shërbimet e shtypjes/printimit	30,687.74	25,866.75	32,914.50
12	13460 - Shërbimet kontraktuese të tjera	398,326.98	215,826.10	179,226.61
13	13470 - Shërbime teknike	18,337.95	5,965.06	10,501.67
14	13471 - Softuerët- Licencat dhe mirëmbajtja e tyre		4,800.00	
15	13475 - Sigurimi fizik i objekteve publike		64,850.24	112,636.16
16	13480 - Shpenzimet e anëtarësimit		10,528.70	7,628.70
17	13501 - Mobilje më pak se 1000 euro	3,738.36	20,523.38	2,772.60
18	13503 - Kompjuterët me pak se 1000 euro	73,673.80	990.00	6,177.79
19	13504 - Hardwer për teknologji informative me pak se 1000 euro	957.20		
20	13505 - Makinat fotokopjuese -multifunksionale		980.00	
21	13509 - Pajisje tjera	2,134.56	4,326.10	2,436.00
22	13610 - Furnizimet për zyrë	35,957.58	21,366.10	48,800.34
23	13611 - Furnizime me dokumenta blanko (certifik. te lindje, kurorëzimi et	12,640.00	3,042.40	
24	13620 - Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	17,986.18	51,489.31	37,514.01
25	13630 - Furnizime mjekësore	41,554.56	9,640.43	3,555.83
26	13640 - Furnizimet e pastrimit	14,931.95	16,167.57	17,107.85
27	13641 - Furnizim me veshëmbathje	-	-	995.00
28	13710 - Vajëra	5,067.00	-	-
29	13720 - Nafta për ngrohje qendrore	21,570.92	25,348.64	47,541.87
30	13760 - Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	77,478.00	126,630.00	247,352.50
31	13780 - Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	47,938.98	41,338.59	37,765.72
32	13820 - Avancë (Paradhënia)për udhëtime zyrtare	-	-	1,625.97
33	13950 - Regjistrimi i automjeteve	2,929.00	2,402.00	2,510.00
34	13951 - Sigurimi i automjeteve	5,776.49	5,406.61	6,024.73
35	13954 - Kontrollimi teknik i automjeteve		350.00	1,625.60
36	14010 - Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	22,117.22	16,625.20	17,115.50
37	14022 - Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	3,457.40	43,490.76	48,918.10
38	14023 - Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	13,163.84	187,932.97	63,110.07
39	14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	385.60	37,172.03	53,134.77
40	14032 - Mirëmbajtja e rrugëve lokale	179,184.26	138,351.57	261,211.99
41	14040 - Mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe të telekomunikimit	305.00		2,266.00
42	14050 - Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	23,200.60	67,137.00	119,719.70
43	14060 - Mirëmbajtja rutinore		61,695.25	91,473.03
44	14140 - Qiraja për makinëri ne shfrytëzim nga Instit. Publike	1,237.50		
45	14310 - Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	18,910.37	19,150.00	22,499.05
46	14410 - Vendimet gjyqësore	880.30	12,619.22	285,925.76
	MALLËRA DHE SHËRBIME	1,100,588.55	1,291,683.50	1,808,347.03

Vazhdim i tabelës nr. 3

1	13210 - Energjia Elektrike	117,295.86	99,658.09	1 03,816.09
2	13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	26,098.56	19,229.16	15,399.03
3	13230 - Mbeturinat	18,173.90	27,889.50	24,443.70
4	13250 - Telefonia fikse	1,379.62	801.69	760.80
5	13260 - Pagesa - Vendime Gjyqësore			13,000.00
	SHPENZIME TE KOMUNALIVE	162,947.94	147,578.44	157,419.62
1	21200 - Subvencionet për entitetet jopublike	130,900.00	273,386.60	383,968.22
2	22202 - Transferet për përfitues individual tjerë	771,055.52	311,064.00	272,303.00
3	22298 - Pagesat për shërbimet e varrimit		43,410.00	38,000.00
4	22299 - Qiraja për rastet sociale		4,760.00	5,270.00
5	22300 - Vendime Gjyqësore			20,712.52
	SUBVENCIONE	901,955.52	632,620.60	720,253.74

Tabela nr. 4 Projektet kapitale të realizuara Janar-qershor 2025

TABELA NR. 4 SHPENZIMET KAPITALE		Janar - Qershor 2025			
643 SKENDERAJ	Buxheti i planifikuar	Buxheti i shpenzuarë		Totali i shpenzuar	% e realizuar.
10. BUXHETI NGA GRANTET QEVERTARE		Shpenzuar sipas planit	Shpenzuar me vend/gjygjës.		
Kodi ekonomik dhe emërtimi i projekteve					
55789 Dron me paisje përcjellëse	6,000.00	-	-	-	-
43870 Fondi i bashkefinancimit (dfezh-ja)	190,000.00	99,962.96	-	99,962.96	52.61
52596 Blerja dhe mirëmbajtja e kamerave të hapësirave publike në:	10,000.00	9,749.40	-	9,749.40	97.49
52597 Blerja e paisjeve motorike për pastrimin e qytetit	33,000.00	33,000.00	-	33,000.00	100.00
54304 Riparimi dhe zgjerimi i nënndaljeve për autobus dhe mbulimi	64,373.20	64,373.00	-	64,373.00	100.00
55819 ndriqimi publik në qytet dhe bashkësi lokale klinë e epërme,	366,627.00	262,982.00	53,599.27	316,581.27	86.35
52666 Ndërtimi i shëtitores natyrale përgjatë shtratit të lumit kl	40,000.00	-	13,953.89	13,953.89	34.88
54317 Vendosja e nje billbordi ne pika turistike ne prekaz.	17,000.00	11,221.90	-	11,221.90	66.01
55825 Ndërtimi i zonave rekreative në skenderaj, parku "Idriz Rrec	13,000.00	-	-	-	-
55843 Ndërtimi i kendit të lojrave antivandalizëm në qytet në lagj	30,000.00	-	28,517.21	28,517.21	95.06
50056 Kanalizimi fekal syrigane- baje	15,000.00	-	-	-	-
51210 Nd.kanal.kline prekaz turiqevc polac qirez runik likoc rezallë	158,183.43	158,183.00	-	158,183.00	100.00
51211 Nd.trofuareve ndriq.publik ne bl.likofc,kline e,kline m.polac	30,000.00	-	-	-	-
52478 Kanalizimi fekal izbicë-rakinicë-leqinë	10,000.00	-	-	-	-
52556 Kanalizimi aqarevë dhe kopiliq i ulët	20,000.00	20,000.00	-	20,000.00	100.00
52568 Asfaltimi i rrugës në lagjen 3 - prekaz	185,861.00	109,793.87	76,000.00	185,793.87	99.96
52572 Punimi i rrjetit të ujës-jellësit në bl qirez	170,000.00	50,000.00	-	50,000.00	29.41
52615 Rregullimi i subqendrës - runik	277,725.62	20,000.00	107,400.37	127,400.37	45.87
52618 Rregullimi i subqendrës - likoc	389,519.35	180,000.00	65,000.00	245,000.00	62.90
52620 Rregullimi i subqendrës - qirez	222,250.00	75,000.00	97,000.00	172,000.00	77.39
52621 Rregullimi i subqendrës -klinë epërme	10,000.00	-	-	-	-
52631 Ndërtimi i objektit të kompleksi i uçk-së-objekti ç-së	30,000.00	-	-	-	-
52646 Tribunat në stadiumin e qytetit	50,000.00	50,000.00	-	50,000.00	100.00
53903 Unaza e brendeshme 3 krahu kah llausha	244,533.00	100,000.00	44,500.00	144,500.00	59.09
54005 Asfaltimi, riparimi dhe kubezimi i rrugeve ne bl likoc, turi	200,000.00	200,000.00	-	200,000.00	100.00
54281 Asfaltimi i rrugëve në fshatrat:kuqicë,qubrel,kasterc,vitak,	35,000.00	-	35,000.00	35,000.00	100.00
54319 Ndertimi i urave ne fshaterat: aqarevë, llaushë, kufqicë, te	55,000.00	-	55,000.00	55,000.00	100.00
55730 Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "shaban p	25,000.00	-	-	-	-
55733 Ndertimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet,rruga "ali gashi",	20,000.00	-	-	-	-
55772 Ndertimi i muzeut dhe bibliotekës se qytetit	30,000.00	30,000.00	-	30,000.00	100.00
55780 Rregullimi i kulmit të objekteve-banesat e kuqe	20,000.00	-	-	-	-
55785 Ndertimi i kolektorit llaushë-tushilë-aqarevë faza I	20,000.00	-	-	-	-
90313 Kanalizimi fekal ne fshatin kline-e ulet	20,000.00	19,683.00	-	19,683.00	98.42
52302 Paisje mjekësore për nevojat e qkmf-së,qmf-së dhe amf-ve	9,534.00	-	-	-	-
56156 Vendosja e ashensorit në shtepinë e pleqve në qytet	15,000.00	-	-	-	-
55170 Furnizimi me kabinete dhe laboratore te shkollave shfmu "sha	56,518.00	22,723.50	-	22,723.50	-

21 BUXHETI NGA TE HYRAT VETANAKE	Buxheti i planifikuar	Shpenzuar sipas planit	Shpenzuar me vend/gjyges.	Totali i shpenzuar	% e realizuar.
54304 Riparimi dhe zgjerimi i nënndaljeve për autobus dhe mbulimi	50,000.00	-	-	-	-
55819 Ndriqimi publik në qytet dhe bashkësi lokale klinë e epërme.	170,000.00	-	-	-	-
50056 Nanalizimi fekal syrigane- baje	30,000.00	-	-	-	-
52556 Kanalizimi aqarevë dhe kopiliq i ulët	45,000.00	45,000.00	-	45,000.00	100.00
52572 Punimi i rrjetit të ujësjellësit në bl qirez	50,000.00	38,195.00	11,800.00	49,995.00	99.99
52615 Rregullimi i subqendrës - runik	50,000.00	-	-	-	-
52621 Rregullimi i subqendrës - klinë epërme	70,000.00	-	-	-	-
52631 Ndërtimi i objektit të kompleksi i uçk-së-objekti ç-së	70,000.00	-	50,000.00	50,000.00	71.43
52646 Tribunat në stadiumin e qytetit	15,000.00	-	15,000.00	15,000.00	100.00
53903 Unaza e brendeshme 3 krahu kah llausha	25,467.00	25,467.00	-	25,467.00	100.00
54005 Asfaltimi, riparimi dhe kubezimi i rrugëve në bl likoc, turi	60,000.00	60,000.00	-	60,000.00	100.00
54281 Asfaltimi i rrugëve në fshatrat:kuqicë,qubrel,kasterc,vitak,	250,000.00	-	-	-	-
54319 Ndërtimi i urave në fshatrat: aqarevë, llaushë, kufqicë, te	30,000.00	-	-	-	-
55730 Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz rreci" dhe "shaban p	70,000.00	-	-	-	-
55733 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet,rruga "ali gashi",	148,999.00	-	-	-	-
55772 Ndërtimi i muzeut dhe bibliotekës së qytetit	75,000.00	-	-	-	-
55780 Rregullimi i kulmit të objekteve-banesat e kuqe	40,000.00	-	-	-	-
55785 Ndërtimi i kolektorit llaushë-tushilë-aqarevë faza 1	80,000.00	-	-	-	-
90313 Kanalizimi fekal në fshatin klinë e ulet	30,000.00	10,000.00	20,000.00	30,000.00	100.00
52302 Paisje mjekësore për nevojat e qkmf-së,qmf-së dhe amf-ve	37,000.00	19,564.00	11,380.61	30,944.61	83.63
52602 Blerja e tabelave interaktive-digitale në shifru shaban jash	28,614.00	-	28,600.00	28,600.00	99.95
52605 Ndërtimi i këndeve për lojëra në shkollat:shaban jashari ske	22,904.00	22,904.00	-	22,904.00	100.00
55170 Furnizimi me kabinete dhe laboratore të shkollave shifru "sha	42,482.00	-	38,000.00	38,000.00	89.45
52641 Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së	72,927.04	-	-	-	-
Totali 10+21	4,652,517.64	1,737,802.63	750,751.35	2,488,553.98	53.49

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE – DREJTORIVE DHE ZYRAVE

TABELA NR. 5 SHPENIZMET SIPAS PROGRAMEVE

LLOJI I SHPENZIMEVE	PROGRAMET SHPENZUESE TE BUXHETIT 2025						
	Zyra e Kryetarit	Administrata	Inspekcioni	Prokurimi	Z e KK	Buxheti	SHIP
11111 - Paga neto	91,016.60	123,479.28	34,829.79	17,230.35	98,650.71	71,346.23	121,878.09
11121 - Tatimi në të ardhurat personale	6,620.74	6,653.45	2,317.43	1,098.29	6,877.56	4,200.51	7,895.06
11131 - Kontributi pensional - punëtori	5,484.15	7,142.82	2,051.31	895.63	6,382.45	4,166.85	7,946.37
11151 - Sindikatat	9.15	149.08		10.85		102.42	24.96
11152 - Odat profesionale							
11211 - Përvoja e punës	2,685.03	4,921.44	914.73	802.55	691.45	3,382.90	5,849.47
11311 - Kontributi pensional - punëdhënësi	5,484.15	7,142.82	2,051.31	895.63	6,382.45	4,166.85	7,946.37
11411 - Shtesa e veçant për të zgjedhurit					15,039.66		
11431 - Kujdestaria, puna gjatë natës & puna jashtë orarit të punës	982.62	508.09	913.67			72.31	15,335.75
11611 - Shtesat tranzitore	2,882.44					62.84	
PAGAT DHE SHITESAT	115,164.88	149,996.98	43,078.24	20,933.30	134,024.28	87,500.91	166,876.07
13141 - Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	1,122.00	390.00					
13142 - Akomodim për udhëtime zyrtare jashtë vendit	78.00						
13310 - Interneti							
13320 - Telefonia mobile							4,669.10
13330 - Shërbimet postare		326.40					
13410 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit							
13440 - Shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale	4,620.04						
13445 - Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual							
13450 - Shërbimet e shtypjes/printimit	2,750.00				269.31	807.07	3,735.00
13460 - Shërbimet kontraktuese të tjera	1,800.00						8,100.00
13470 - Shërbime teknike							
13480 - Shpenzimet e anëtarësimit		7,628.70					
13475 - Sigurimi fizik i objekteve publike							96,299.84
13501 - Moblijet							
13503 - Kompjuteret		4,705.00		847.99		625.00	
13509 - Pajisje tjera	99.00	350.00					
13610 - Furnizimet për zyrë	2,533.90	3,782.50	2,999.90	1,610.19		2,793.90	
13620 - Furnizimi me ushqim dhe pije (jo drëka zyrtare)	5,476.20	740.75	594.30		1,495.70	628.50	588.50
13630 - Furnizimi mjeksore							
13640 - Furnizimet e pastrimit	600.00						1,517.30
13650 - Furnizimi me veshmbathje							
13720 - Nafta për ngrohje qendrore		7,560.25					
13760 - Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje							4,075.00
13780 - Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	4,537.79	4,161.27	939.94		672.70	937.59	2,591.96
13820 - Avancë (Paradhënia) për udhëtime zyrtare	1,625.97						
13950 - Regjistrimi i automjeteve	75.00	75.00	75.00				1,010.00
13951 - Sigurimi i automjeteve	30.00	313.79	313.79				1,629.24
13954 - Kontrollimi teknik i automjeteve	965.60	60.00	30.00				150.00
14010 - Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		2,871.00	445.00		780.00	380.00	1,532.00
14022 - Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste		9,424.80					31,041.10
14023 - Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore							10,033.00
14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore							
14032 - Mirëmbajtja e rrugëve lokale		3,500.00	35,946.00				214,865.99
14040 - Mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe të telekomunikimit		2,266.00					
14050 - Mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve		3,630.00					53,186.50
14060 - Mirëmbajtja rutinore							88,473.03
14310 - Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	5,025.05	2,716.70			2,843.20	1,625.97	
14410 - Vendimet gjyqësore		13,241.00	40,000.00				38,898.23
MALLËRA DHE SHËRBIME	31,338.55	67,743.16	81,343.93	2,458.18	6,060.91	7,798.03	562,395.79
13210 - Energjia Elektrike							49,082.01
13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit							1,989.39
13230 - Mbeturinat							1,069.16
13250 - Telefonia fikse							570.07
13260 - Pagesat - Vendime Gjyqësore							13,000.00
SHERBIMET E KOMUNALIVE	-	-	-	-	-	-	65,710.63
21200 - Subvencionet për entitetet jopublike							4,100.00
22202 - Transferet për përfitues individual tjerë	29,200.00						9,300.00
22298 - Pagesat për shërbimet e varrimit							38,000.00
22299 - Qiraja për rastet sociale							
22300 - Vendime Gjyqësore							8,600.00
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	29,200.00	-	-	-	-	-	60,000.00

TABELA NR. 5 SHIPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE

LLOJI I SHIPENZIMEVE	ZLK	Bujqesia	Pl.dhe.zhv.e k.	GJK dhe P	Urbanizmi	Shendetesi	K,R dhe S	Arsimi
1111 - Paga neto	22,880.59	38,458.55	32,627.15	44,022.45	45,099.71	781,181.43	61,968.80	2,909,150.62
1112 - Tatimi në të ardhurat personale	1,197.04	2,106.73	1,960.67	2,544.15	2,668.77	54,858.48	3,539.30	175,603.62
1113 - Kontributi pensional - punëtori	1,327.60	2,202.37	1,871.44	2,558.83	2,644.73	49,034.19	3,593.50	171,678.36
1115 - Sindikatat	13.56	51.90	2.74	20.66		1,730.41	31.67	9,301.44
11152 - Odat profesionale						5,405.34		200.00
1121 - Përvoja e punës	1,131.81	1,228.15	966.08	1,943.55	2,164.65	36,674.12	2,450.32	154,425.70
1131 - Kontributi pensional - punëdhënësi	1,327.60	2,202.37	1,871.44	2,558.83	2,644.73	49,034.19	3,593.50	171,678.36
1141 - Shtesa e veçantë për të zgjedhurit								
11431 - Kujdestaria, puna gjatë natës & puna jashtë orarit të punës				85.35	316.25	49,905.25	284.59	13,673.91
1161 - Shtesat tranzitore						1,874.69		
PAGAT DHE SHITESAT	27,878.20	46,250.07	39,299.52	53,733.82	55,538.84	1,029,698.10	75,461.68	3,605,712.01
13141 - Para shërbimit për udhëtime zyrtare jashtë vendit		130.00						1,122.00
13142 - Akomodim për udhëtime zyrtare jashtë vendit								
13310 - Interneti								4,560.00
13320 - Telefonia mobile		921.60				570.00		2,070.00
13330 - Shërbimet postare								
13410 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit								9,096.00
13440 - Shërbimet këshillëdhënëse dhe profesionale	1,928.50							
13445 - Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	505.49	592.50			3,557.98			
13450 - Shërbimet e shtypjes/printimit			1,999.00	5,426.57	421.31	3,083.39	5,344.70	9,078.15
13460 - Shërbimet kontraktuese të tjera					58,615.41	89,805.70		20,905.50
13470 - Shërbime teknike		2,835.00			7,386.67	280.00		
13480 - Shërbimet e anëtarësimit								
13475 - Sigurimi fizik i objekteve publike								16,336.32
13501 - Moblijet			747.00					2,025.60
13503 - Kompjuteret								
13509 - Pajisje tjera								1,987.00
13610 - Furnizimet për zyrë			2,499.90		1,784.90	6,106.35		24,688.80
13620 - Furnizimi me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	300.00		675.50	590.20	908.30	13,210.72	85.45	12,219.89
13630 - Furnizimi mjekësor						3,555.83		
13640 - Furnizimet e pastrimit						1,565.55	347.18	13,077.82
13650 - Furnizimi me veshmbathje								995.00
13720 - Nafta për ngrohje qendrore			2,041.00			28,225.92		9,714.70
13760 - Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	1,630.00					3,187.50		238,460.00
13780 - Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	275.41	2,044.03	103.66	453.13	813.07	13,291.67	3,383.11	3,560.39
13820 - Avancë (Paradhënia) për udhëtime zyrtare								
13950 - Regjistrimi i automjeteve		490.00				710.00		75.00
13951 - Sigurimi i automjeteve		2,162.99				1,380.67		194.25
13954 - Kontrollimi teknik i automjeteve		340.00				50.00		30.00
14010 - Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		495.00	389.00	345.00	330.00	8,843.50	705.00	
14022 - Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste				1,698.20		5,700.00	1,054.00	
14023 - Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore					6,825.00			46,252.07
14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore						53,134.77		
14032 - Mirëmbajtja e rrugëve lokale		3,500.00				3,400.00		
14040 - Mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe të telekomunikimit								
14050 - Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve		1,062.00			11,970.00	25,299.00		24,572.00
14060 - Mirëmbajtja rutinore		3,000.00						
14310 - Kompensimi i përfqësimit brenda vendit			104.60			318.00	1,039.53	8,826.00
14410 - Vendimet gjyqësore					62,161.66	72,655.00		58,969.87
MALLËRA DHE SHËRBIME	4,639.40	17,573.12	8,559.66	8,513.10	154,774.30	334,373.57	11,958.97	508,816.36
13210 - Energjia Elektrike						22,871.70		31,862.38
13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit						3,342.54		10,067.10
13230 - Mbeturinat						6,004.53		17,370.01
13250 - Telefonia fikse						190.73		
13260 - Pagesat - Vendime Gjyqësore								
SHERBIMET E KOMUNALIVE						32,409.50		59,299.49
21200 - Subvencionet për entitetet jopublike		150,000.00	76,568.22				153,300.00	
22202 - Transferet për përfitues individual tjerë						141,260.00	4,050.00	88,493.00
22298 - Pagesat për shërbimet e varrimit								
22299 - Qiraja për rastet sociale						5,270.00		
22300 - Vendime Gjyqësore		12,112.52						
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE		162,112.52	76,568.22			146,530.00	157,350.00	88,493.00

Drejtori i DBF-së

Z. Ismet Aliu

Kryetari i Komunës

Z. Fadil Nura





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
STATUTI I KANCELARIJES			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shit.klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. faqeve Br. Stranica No. Pages
04	47	1123	1

ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Per:	Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skënderajt Kryetarin e Kuvendit Komunal të Komunës së Skënderajt
Kopje elektronike:	Kryetar KMFP Kryetar KBPT
Nga:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt për vitin 2024.

Nr. Zyrës:	Ext:	Data: 26.06.2025
------------	------	------------------

Data	Zyra e Pranimi	Komentet/Vepimet	Inicialet	Afati
		Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt për vitin 2024. Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SKËNDERAJT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Skënderajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skënderajt (SK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpenzime në vlerë 937,133€ janë paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.
- A1 Vlera e detyrimeve kontigjente të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishte mbivlerësuar për 113,072€.
- B2 Pasuritë jofinanciare të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishin nënvlerësuar për 120,806€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Skënderajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Mangësi në menaxhimin e kontratës me çmim të poentuar;
- B3 Në 16 raste, faturat në vlerë 449,008€ nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimit;
- A3 Në katër (4) raste kishte dobësi në proceset e subvencionimit të OJQ-ve, dhe një (1) rast të përfituesit individual;
- A4 Në një rast, sigurimi i ekzekutimit të kontratës në vlerë 22,000€, nuk ishte bërë sipas afatit të përcaktuar me dosje të tenderit.
- A5 Komuna nuk kishte arritur që brenda vitit të bëjë verifikimin e së paku 20% të pronave të tatueshme; dhe
- B4 Për nëntë (9) kontrata të punëve të përfunduara nuk ishte bërë vlerësimi i performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratave në platformën e-Prokurimi.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Skënderajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Skënderajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Skënderajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Skënderajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Skënderajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Kontrollet e brendshme gjatë procesit të raportimit financiar duhet të avancohen. Përmirësimet janë të nevojshme gjatë përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare dhe shpalosjeve të shënimeve shpjeguese për detyrimet kontigjente dhe pasurisë jo financiare. Në aspektin e pajtueshmërisë, përmirësime janë të nevojshme në regjistrimin e pagesave në kategoritë përkatëse, menaxhimin e duhur dhe realizimin me kohë të kontratave publike, pagesën brenda afateve të obligimeve ndaj kontraktuesve, proceset e subvencionimit dhe menaxhimit të pasurisë, menaxhimit të tatimit në pronë dhe arkëtimit me kohë të taksave për lejen ndërtimore.

Ky raport ka rezultuar me njëmbëdhjetë (11) rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura, dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

Gjetja

Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF-Shpenzimi i parave publike, neni 18, pika 3, përcakton që shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me udhëzimin administrativ për planin kontabël. Me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Rezultatet e testimeve identifikuan se pagesat në vlerë totale 937,133€ nuk janë klasifikuar në kategorinë e duhur ekonomike. Keq-klasifikimet kanë rezultuar te këto kategori ekonomike:

- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, të cilat kanë të bëjnë pagesat për kontratën kolektive të punonjësve të arsimit, janë paguar 769,465€ nga buxheti i kategorisë së investimeve kapitale, dhe 92,692€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Për shpenzime të pajisjeve dhe materialit laboratorik shkollor, që për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, janë paguar 74,976€ nga buxheti i investimeve kapitale.

Gjithashtu, një mostër/pagesë në vlerë 35,000€ e procesuar nga Thesari, nga vendimet gjyqësore, komuna nuk ka arritë të na sigurojë lëndën.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pagesave nga Thesari si rezultat

vendimeve gjyqësore të ndërlidhura me kontratën kolektive për punonjësit e arsimit, si dhe planifikimeve të gabuara buxhetore. Derisa shkak i mosofrimit të dëshmisë është si rezultat i mos kërkeses me kohë të këtyre lëndeve në Thesar nga ana e komunës dhe vonesave të thesarit në përgjigje.

Ndikimi Regjistrimi i shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF. Shfrytëzimi i buxhetit të investimeve kapitale për pagesën e shpenzimeve që i takojnë kategorive ekonomike tjera, vështirëson realizimin me kohë dhe si duhet të projekteve kapitale.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet nga kategoritë ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja Rregullorja MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga OB-të, neni 6, përcakton që OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Vlera e detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare ishte mbivlerësuar për 113,072€, pasi që në regjistër ishin evidentuar nëntë lëndë për të cilat komuna kishte bërë marrëveshje me paditësit dhe lëndët në gjykatë ishin vlerësuar me vendim të formës së prerë dhe vazhdimit të procedurës së përmbarrimit, si dhe në një lëndë tjetër vlera e kontestit nuk ishte prezantuar saktë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë në përditësimin e informatave në regjistrin e kontigjencave dhe prezantimin financiar.

Ndikimi Mos azhurnimi me kohë i regjistrit të detyrimeve kontigjente ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontigjente dhe prezantimin jo të saktë të tyre në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që lista e detyrimeve kontigjente azhurnohet me kohë, dhe se lëndët për të cilat janë bërë marrëveshjet me paditësit dhe komunës, e të cilat janë në procedurë të përmbarrimit të mos prezantohen si detyrime kontigjente.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Nënvlërësimi i pasurive në pasqyrën vjetore financiare

Gjetja Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.3 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Pasuritë jokapitale në vlerë 74,977€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e

pasurisë e-pasuria, si dhe pasuritë kapitale në vlerë 45,829€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK. Si rezultat, pasuritë jofinanciare të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare ishin nënvlerësuar në total për 120,806€. Pas përfundimit të auditimit, nga komuna pranuan dëshmi se në vitin 2025 pasuritë kapitale në vlerë 45,829€ janë regjistruar në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës në regjistrimin e pasurive jo financiare.

- Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurisë jofinanciare ka ndikuar në mos raportimin e drejtë dhe të saktë të pasurisë në pasqyrat vjetore financiare.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mangësi në realizim të kontratës me çmim të poentuar

Gjetja	Rregullorja nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 54.15, sqaron se kurdo që AK nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani +/-30%. Duke pasur parasysh faktin se peshimi i kategorive duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që vlera e realizuar (shpenzuar) nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit. Kontrata publike me çmim të poentuar "Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe lumenjve në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turçec, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezallë", në vlerë 1,400,000€, në total ishte realizuar në vlerën e planifikuar, megjithatë, shpenzimet e planifikuara për kategorinë e parë të peshuar me 65% apo 910,000€, ishin realizuar në vlerë 1,207,898€, duke tejkaluar limitin e lejuar për 297,898€ apo 33%. Më tutje, kategoria 3 me peshë 3% apo 42,000€ nuk ishte realizuar fare, derisa kategoria 2 me peshë 7% apo 98,000€, ishte realizuar vetëm 0.7% apo 6,749€. Kjo kishte ndodhur për shkak të mangësive në planifikimin e saktë të nevojave dhe mungesës së kontrolleve të duhura nga menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt në monitorimin e projekteve.
Ndikimi	Mos ruajtja e përqindjes apo peshimit të kategorive të kontraktuara shkakton kosto shtesë buxhetore për shkak se raporti i peshimit ishte faktori kryesor në përzgjedhjen e tenderit apo ofertës më të lirë gjatë procedurës së prokurimit.
Rekomandimi A2	Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale. Po ashtu nevojitet mbikëqyrje më aktive gjatë realizimit të kontratave nga ana e menaxherëve të kontratave, ashtu që vlera e realizuar e kategorisë të mos tejkalojë peshën apo limitin e vlerës së kontraktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mos pagesa me kohë e obligimeve dhe kosto shtesë buxhetore për shkak të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Gjetja	Neni 41 i Rregullës financiare nr. 01/20213/MF shpenzimi i parasë publike, përcakton që, organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës.
--------	--

Në 16 raste, faturat në vlerë 449,008€ nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimit. Vonesat ishin nga 7 ditë deri 180 ditë.

Gjithashtu, sipas regjistrave të siguruar nga Komuna, gjatë vitit 2024, si rezultat i procedurave përmbare dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, si dhe obligimeve nga kontrata kolektive për personelin arsimor, në emër të kamatave, tarifave të përmbare dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, janë paguar kosto shtesë në vlerë 436,423€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të menaxhimit jo të duhur të obligimeve, dhe hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore.

Ndikimi	Vonesa në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, ndikon që komuna të jetë subjekt i padive nga kontraktuesit, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.
Rekomandimi B3	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe të siguroj se detyrimet ndaj kontraktuesve paguhen brenda afateve kohore, duke shmangur në këtë mënyrë kostot shtesë për shkak të procedurave gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Dobësi në proceset e subvencionimit të OJQ-ve dhe përfituesve individual

Gjetja	Rregullorja e brendshme për subvencionim nr. 01-400/01-003/689/20 e datës 04.12.2020, neni 20, subvencionet për kulturë, rini, dhe sport, pika 1.3.5, përcakton që: dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve, përfshijnë ndër të tjera: lraportin e auditimit të jashtëm për klubet që përfitojnë shumën mbi (5) mijë euro brenda vitit kalendarik. Po ashtu, neni 5 paragrafi 2, i rregullores së njëjtë specifikon se, përfituesi i subvencioneve mund të jetë vetëm një herë në vit personi fizik dhe juridik, me përjashtim të rasteve për personin fizik në fushën e shëndetësisë, për nevoja të shërimit dhe sigurimit të ushqimeve (mirëqenie sociale) dhe në fushën e bujqësisë. Më tutje, neni 13 i po kësaj rregullore, specifikon se Komuna ndan bursa për studentët, nxënësit, shkollimin deficitar, nxënës me nevoja të veçanta, gara apo kuize, botimin e librave, nxënës që kane treguar rezultate të mira në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Më tutje, sipas rregullores MF.Nr. 04/2017 Mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 13 kriteret e thirrjes publike dhe dokumentacioni i kërkuar pika 1 thirrja publike duhet të përmbajë informacionin në vijim: 1.1 udhëzimet e thirrjes për aplikantët, duke përfshirë kriteret për përzgjedhjen e përfituesve. Gjatë testimit të procedurave të subvencionimit të OJQ-ve dhe përfituesve individual, kemi identifikuar këto mangësi: Në tri (3)⁵ raste të subvencionimit të OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, në vlerë totale 40,400€, përfituesit nuk i kishin plotësuar kriterin e përcaktuar me rregulloren e brendshme për subvencionim. Kjo pasi, të njëjtit nuk kishin sjellë raportin e auditimit të jashtëm ashtu siç kërkohej me rregulloren e komunës. Për të
---------------	---

njëjtat raste, Komuna nuk kishte publikuar udhëzuesin për aplikantët në thirrjet përkatëse.

- Te procedura e subvencionimit për projektin "Festivali gjithëkombëtar "Rapsodia Shqiptare", në vlerë 17,800€, kemi identifikuar që Komuna kishte subvencionuar këtë OJQ edhe dy herë brenda vitit kalendarik 2024, përkundër që me kriteret e rregullores përkatëse, përfitues i subvencioneve mund të jetë vetëm një herë në vit. Vlera e përgjithshme e subvencionimeve brenda vitit ishte 33,700€.
- Në pagesën në emër të bursave për studentet, Komuna kishte financuar me vlerë 3,500€ transportin e nxënësve me nevoja të veçanta dhe kushte jo të mira ekonomike. Pagesa ishte bërë bazuar në vendimin e Drejtorit të Drejtorisë Komunale për Arsim, derisa përfituesi ishte një person fizik i përzgjedhur nga prindërit e nxënësveve përmes nënshkrimeve dhe jo përmes procedurave ligjore për përzgjedhjen e përfituesit.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos zbatimit të procedurave dhe akteve rregullative përkatëse nga ana e personave përgjegjës gjatë procedurave të thirrjes publike dhe vlerësimit të kërkesave për subvencionim.

Ndikimi

Dhënia e subvencioneve në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe në kundërshtim me rregulloren në fuqi ndikon në trajtim jo të barabartë të aplikuesve, rritë rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe qëllimi i subvencionimit mos të arrihet.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi dhe miratimi i kërkesave për subvencionim të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore dhe brenda fushëveprimit ligjor të komunës. Po ashtu, shtohet mbikëqyrja në procesin e vlerësimit të kërkesave, për të parandaluar miratimin e ndihmave në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ose për qëllime që tejkalojnë kompetencat e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Siguria e ekzekutimit të kontratës jo në afatin e duhur

Gjetja

Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit për kontratën "Furnizim me mallra dhe shërbime për nevojat e DKRS-së dhe drejtorive tjera në Komunën e Skenderajt" përcaktonte që sigurimi i ekzekutimit të jetë në kohëzgjatje prej 37 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në kontratën "Furnizim me mallra dhe shërbime për nevojat e DKRS-së dhe drejtorive tjera në Komunën e Skenderajt", me vlerë të parashikuar 220,000€, siguria e ekzekutimit nuk mbulonte afatin e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit prej 37 muaj, pasi që fituesi i tenderit e kishte ofruar sigurimin e ekzekutimit në afat prej 13 muaj.

Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit lidhur me sigurimin e ekzekutimit të kontratës është rezultat i mungesës së kontrollit adekuat nga autoriteti kontraktues para nënshkrimit të kontratës.

Ndikimi

Pranimi sigurimit të ekzekutimit me kohëzgjatje më të shkurtër rrezikon autoritetin kontraktues të mos ketë mbrojtje të mjaftueshme financiare në rast të mos përmbushjes së kontratës nga kontraktuesi.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike të nënshkruhen vetëm atëherë kur kontraktuesi të ofrojë sigurinë e ekzekutimit në afatin e përcaktuar me dosje të tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Përqindje e ulët e inspektimit të pronave për tatimin në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 15, parashihet se: "Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës".

Komuna gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur të bëjë inspektimin apo verifikimin e së paku 20% të pronave të regjistruara brenda territorit të Komunës. Gjatë vitit, komuna kishte bërë inspektimin e vetëm 16.4% të pronave të përgjithshme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe angazhimeve të pamjaftueshme për verifikimin e pronave sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos inspektimi i pronave rezulton me informata jo të plota të pronave aktuale dhe me ndikim në vlerësim jo të drejtë dhe të saktë të ngarkesave për tatimin në pronë, përkatësisht të hyra vetanake më të pakta nga tatimi në pronë.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mos vlerësimi i performances së kontraktuesve përmes platformës e-prokurimi nga menaxherët e kontratave

Gjetja Neni 70, pika 25, e Rregullorës 001/2022 për prokurimin publik, përcakton që, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për shqyrtimin, aprovimin dhe procedimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij/saj. Gjithashtu, pika 61 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik kërkohej që regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Për nëntë (9)⁶ kontrata publike të përfunduara, menaxherët e projekteve dhe mbikëqyrësit e menaxherëve nuk kanë bërë vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratës në platformën e-prokurimi. Gjithashtu, edhe në dhjetë (10) kontrata për mallra dhe shërbime, menaxherët e kontratave të dhënat rreth kontratave nuk i kanë arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme dhe mos

zbatimit të kërkesave rregullative për menaxhim dhe vlerësim të implementimit të kontratave publike.

Ndikimi

Mos përditësimi i informatave rreth implementimit të projekteve në modul elektronik pamundëson analizimin, përcjelljen dhe vlerësimin e performancës së realizimit të kontratave publike. Kjo gjithashtu, mundëson që mangësi të ndodhura në menaxhim të kontratave të shfaqen edhe në të ardhmen.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë të menaxherëve, vendosin informatat rreth implementimit të projekteve dhe bëjnë vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit të menaxhimit të kontratave në platformën e-prokurimi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,439,268€, dhe gjatë vitit 2024 ishin shpenzuar 5,337,594€. Investimet kapitale përbëhen nga investimet në infrastrukturën rrugore, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, etj.

Çështja A6 - Vonesa në realizim të projekteve kapitale

Gjetja

Sipas nenit 70.23 të Rregullës nr. 001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Testimet tona rezultuan me tre (3) projekte kapitale që nuk ishin realizuar në afatin kohor të përcaktuar me kontratë. Rastet janë të këto projekte:

- Kontrata e punëve "Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Qirez, Prellovc, Baks, Krasaliq, Kozhicë, Krasmirovci L=61,184M", në vlerë totale në vlerë 1,190,000€, duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2020, derisa është përfunduar në shkurt 2023, apo me 25 muaj vonesë;
- Kontrata e punëve "Rehabilitimi dhe funksionalizimi i projektit - Ta shijoni qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra në Skenderaj", në vlerë 189,117€, duhej të përfundonte në tetor 2022, derisa është përfunduar në dhjetor 2023, apo me 12 muaj vonesë; dhe
- Kontrata "Blerja e pajisjeve motorike për mirëmbajtjen e qytetit të Skenderajt", në vlerë 163,000€, furnizimi duhej të përfundonte brenda 30 ditëve, derisa pajisjet ishin liferuar me 3 muaj vonesë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme nga ana e menaxherëve të kontratave, por edhe mungesës buxhetore të ndodhura nga pagesat e realizuara nga fondi i investimeve kapitale për shkak të vendimeve gjyqësore.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mos arritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e kontratave në mënyrë që të sigurojë që kontratat publike realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2024 në total janë 1,821,029€. Vlera e të arkëtueshmeve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë (79%), taksat komunale në biznes (11%), dhe (10%) nga qiraja nga shfrytëzimi i pronave.

Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja	Kontrata nr.05/353-10 mbi dhënien e lokalit afarist me qira, neni 2 përcakton " Marrësi i lokalit me qira obligohet që qiranë e caktuar nga Komuna ta paguaj në afatin e rregullt për çdo muaj eventualisht deri më datën 5 të muajin vijues, nëpërmes Skëtorit të pronave të kësaj drejtorie në llogarinë e caktuar të buxhetit të Komunës" Gjithashtu në kontratën nr.05/464-213 mbi dhënien e tokës publike në shfrytëzim të përkohshëm me qira, neni 3 përcakton " Shfrytëzuesi i tokës publike obligohet që për shfrytëzimin e tokës të paguaj qira (rentë) vjetore për m2 për çdo vit sipas tarifës së caktuar në rregulloren komunale në fuqi, në të kundërtën për mos pagesën e qirasë do të mirret toka nga shfrytëzimi, ndërsa borxhi i mbetur do të kërkohej sipas ligjit nëpërmes gjykatës". Komuna nuk kishte bërë menaxhimin efektiv të llogarive të arkëtueshme për rentën dhe qiranë nga shfrytëzimi i pronave publike. Testimet tona rezultuan që, në dy raste për rentën nga prona publike në vlerë 22,870€, dhe një rast nga qiraja për shfrytëzimin e pronës publike në vlerë 7,450€, komuna kishte njoftuar qiramarrësit për pagesën e obligimeve të papaguara që kanë ndaj komunës, por jo edhe veprime tjera ligjore brenda vitit 2024 për arkëtimin e borxhit. Borxhi i përgjithshëm për qiratë dhe rentën nga prona publike ishte rritur në 167,151€, për dallim nga vitit 2023 që ishte 153,717€. Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.
Ndikimi	Mos inkasimi i të arkëtueshmeve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.
Rekomandimi C1	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmblodhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmblodhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	18,582,311	21,113,589	20,949,548	18,709,687	14,195,206
Grante Qeveritare - Buxheti	17,283,040	18,467,038	18,359,973	16,257,693	12,543,990
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	129,597
Të bartura nga viti i kaluar	0	344,429	322,124	417,798	309,371
Të hyrat vetanake	1,299,271	1,688,798	1,658,354	1,607,215	1,197,791
Donacionet vendore	0	1,881	0	420,575	0
Donacionet e jashtme	0	611,442	609,096	6,406	14,456

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 2,531,278€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 1,183,999€, ndryshimit të planit të të hyrave vetanake për 389,527€, të hyrat e bartura nga viti paraprak në vlerë 344,429€, si dhe 613,324€ nga donacionet.

Në vitin 2024 Komuna Skenderaj ka shpenzuar 99% të buxhetit përfundimtar ose 20,949,548€, me një përmirësim prej 1% në krahasim me vitin 2023 ku realizimi ishte 98%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	18,582,311	21,113,589	20,949,548	18,709,687	14,195,206
Pagat dhe mëditjet	10,529,849	11,720,442	11,719,195	9,758,084	8,127,199
Mallrat dhe shërbimet	2,386,428	2,521,771	2,491,898	2,474,417	1,773,318
Komunalitë	289,323	324,127	303,122	317,868	198,310
Subvencionet dhe transferet	1,002,000	1,107,980	1,097,739	1,407,504	803,249
Investimet Kapitale	4,284,711	5,439,268	5,337,594	4,751,813	3,293,129
Rezervat	90,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për paga dhe mëditje është rritur për 1,190,593€. Rritja është ndikuar nga vendimet e qeverisë për mbulimin e mungesës buxhetore të shkaktuar nga pagesat e vendimeve gjyqësore në vlerën 1,183,999€, dhe 6,595€ nga donacionet. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte 100%.
- Buxheti i mallrave dhe shërbimeve është rritur për 135,343€. Rritja është ndikuar nga ndryshimi i planit të të hyrave vetanake për 131,551€, nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar për 1,826€, dhe 1,966€ nga donacionet. Realizimi i buxhetit të kësaj kategori në fund të vitit ishte 98.8%.
- Buxheti final për shërbimet komunale është rritur për 34,804€. Kryesisht rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar për 19,804€, dhe nga rritja e planit të të hyrave vetanake për 15,000€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte 93.5%.
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 105,980€. Rritja është ndikuar nga ndryshimi i planit vjetor të të hyrave vetanake për 79,837€, nga të hyrat e bartura të vitit të kaluar për 25,032€, dhe 1,111€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.1%.
- Buxheti për investime kapitale është rritur për 1,154,557€. Kryesisht rritja është ndikuar nga pranimi i donacioneve në vlerë 603,652€, të hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë 297,767€, nga ndryshimi i planit vjetor të të hyrave vetanake për 163,139€, dhe nga rialokimi i 90,000€ prej kategorisë së rezervave. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 98.1%. Programi i Investimeve Publike përfshin 56 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për investimet në infrastrukturën rrugore, ndriçimit publik, salla sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, lumenjve, parqe, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2024 ishin 1,575,277€, derisa ishin planifikuar 1,299,271€, duke tejkaluar planin për 276,006€. Ato kanë të bëjnë kryesisht nga taksat për leje ndërtimore, tatimi në pronë, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, participimet, si dhe taksa tjera komunale. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar ulje prej 211,161€, që kryesisht i përket të hyrave tatimore, përkatësisht tatimit në pronë.

Në vitin 2024 Komuna ka përfituar 120,626€ të hyra nga gjobat në trafik, 20,345€ nga gjobat e gjykatave, dhe 90€, nga Agjencioni i Pyjeve, apo në total 149,061€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	1,299,271	1,299,271	1,575,277	1,786,438	1,444,554
Të hyrat tatimore	377,870	377,870	217,509	374,702	336,698
Të hyrat jo tatimore	921,401	921,401	1,357,590	1,411,736	1,107,856
Të hyrat tjera	0	0	178		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 për Komunën Skenderaj ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit të vitit 2023 ishte diskutuar në kuvendin komunal. Gjithashtu, Komuna kishte përgatitur edhe raportin periodik për progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të vitit 2023.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim është zbatuar; një (1) në proces të zbatimit, katër (4) nuk janë zbatuar, dhe një (1) nuk është i zbatueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që pranimi i mallit të blerë, të bëhet vetëm nga komisioni i autorizuar, për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
2.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Nuk është i aplikueshëm më.	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe këtë vit janë prezente keqklasifikimet e shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës.	Edhe këtë vit kemi nënvlerësim të pasurisë në pasqyrat vjetore financiare.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.	Janë ndërmarrë veprime tek disa lloje të llogarive të arkëtueshme.	Pjesërisht i zbatuar
7.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të fondeve buxhetore, si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur fondet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik.	Edhe këtë vit kemi raste të mos pagesës me kohë të obligimeve.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit




Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

		
Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo		Kuvendi i Komunës Skenderaj Skupština Opštine Skenderaj Skenderaj Municipal Assembly
Zyra e Kryetarit /Kabineti Predsednika / Office of the Mayor		
LETËR E KONFIRMIMIT		
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve		
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit		
Të nderuar,		
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:		
• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti"); • <u>pajtohem</u>/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshtatet nga entiteti) • brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.		
Fadi Nura		
Kryetar i Komunës së Skenderajt,		
Data 23.06.2025, Skenderaj,		

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare^a duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet^a, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinjon të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ OJQ Skenderaj live me 17,800€, K.F Drenica me 13,000€, K.F Drenica & Tradita me 9,600€, dhe Anita Sinani 3,500€.
- ⁶ Kontratat publike: Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Qirez, Prelloc, Baks, Krasaliq, Kozhicë, Krasmirovic në vlerë 1,190,000€, Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe lumenjëve në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiçec, Polac, Qirez, Runik, Likoc dhe Rrezallë në vlerë 1,400,000€, Punimi i kanalizimit në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiçec, Polac, Qirez, Runik, Likoc dhe Rrezallë në vlerë 525,001€, Blerja e pajisjeve motorike për mirëmbajtjen e qytetit të Skenderajt në vlerë 163,000€, Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF në vlerë 317,898€, Rregullimi i shtratit të lumit Klina në vlerë 221,590€, Rehabilitimi dhe funksionalizimi i projektit - Ta shijojmë qytetin në këmbë në rrugën Ilaz Kodra në vlerë 172,488€, Ndërtimi i këndeve të lojrave në shkollat e komunës së Skenderjat në vlerë 59,904€, Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në fshatrat Kuçicë, Çyçavicë, Radishevë, Tushillë, faza II në vlerë 54,833€.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SKENDERAJ/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKENDERAJ
SKENDERAJ
Nr. 04-052/010026963/25
Data 09 07 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Për: Zyren Kombëtare të Auditimit

Nga: Kryetar i Komunës së Skenderajt z. Fadil Nura

Data : 08.07.2025




PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË JASHTËM

N r.	Të gjeturat/gëshjtet	Rekomandimet	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Datat e përcaktuar a	Bartësit/ Drejtoritë përkatëse
1	Gëshhtëja B1 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet nga kategoritë ekonomike adekuate.	Kryetari, ZKF dhe Drejtoret e drejtorive/ Zyrave ne koordinim dhe bashkëpunim me zyrtarët e sektorit për buxhet dhe thesar do te forcojnë kontrollin e brendshëm ne mënyre qe te procedohet çdo shpenzim nga kodi adekuat sipas plani kontabël.	01.07.2025 dhe ne vazhdimësi	ZKF Drejtoret e Drejtoreve/ Zyra ve
2	Gëshhtëja A1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare	Kryetari duhet të sigurojë që lista e detyrimeve kontigjente azhurnohet me kohë, dhe se lëndët për të cilat janë bërë marrëveshjet mes paditësit dhe komunës, e të cilat janë në procedure të përbarimit të mos prezantohen si detyrime kontigjente.	Kryetari dhe Avokati i Komunës do te përditësojnë listën e detyrimeve kontingjente për te caktuar saktë këto detyrime dhe ato te vendime te formës se prete te trajtohen si obligime ne PFV.	30.09.2025	Kryetari Avokati i Komunës dhe ZKF
3	Gëshhtëja B2 - Nënvlerësimi i pasurive në pasqyrën vjetore financiare	Kryetari duhet të forcojë kontrolltet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës.	Kryetari do te forcoj kontrolltet e brendshme te rexhistrimi i pasurisë, me theks te veqant te E-Pasuaria qe te jete ne rexistra kontabël, ndërsa pasuritë kapitale janë rexhistruar te gjitha, edhe dy rastet e mbetura ishin ne rexistra kontabël por gjatë vitit aktual.	30.09.2025	Drejtoria e Buxhetit dhe e Arsimit

4	Çështja A2 - Mangësi në realizim të kontratës me çmim të poentuar	Kryetari duhet të sigurojë përmes njërive kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale. Po ashtu nevojitet mbikëqyrje më aktive gjatë realizimit të kontratave nga ana e menaxherëve të kontratave, ashtu që vlera e realizuar e kategorisë të mos tejkalojë peshën apo limitin e vlerës së kontraktuar.	Kryetari dhe njësia kërkuese do të ketë parasysh dhe të behet planifikim i mirëfillte që mos të ndodhin këto mangësi, gjegjësisht menaxheret e kontratave do të përcjellin kuotimin e saktë dhe nuk do të ketë tejkalime, dhe ky proces do të monitorohet për të gjitha kontratat.	Nga 01.07.2025 dhe ne vazhdimësi	Menaxheret e kontratave Drejtoria e Prokurimit dhe Urbanizmit
5	Çështja B3 - Mos pagesa me kohë e obligimeve dhe kosto shtesë buxhetore për shkak të vendimeve gjyqësore dhe përbarimore	Kryetari duhet të forcojë kontrollin në menaxhimin e obligimeve dhe të siguroj se detyrimet ndaj kontraktuesve paguhen brenda afateve kohore, duke shmanjur në këtë mënyrë kostot shtesë për shkak të procedurave gjyqësore.	Kryetari, ZKF dhe Drejtoret e drejtorive/Zyrave në koordinim dhe bashkëpunim me vartësit e vet do të forcojnë kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikohet buxhet për vendime gjyqësore dhe përbarimore çdo shpenzim nga kodi adekuat sipas plani kontabël.	Nga 01.01.2026 dhe në vitet e ardhshme	Te gjitha Drejtoritë dhe Zyrat që janë Autorizues të buxheut
6	Çështja A3 - Dobësi në proceset e subvencionimit të OJQ-ve dhe përfutuesve individual	Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi dhe miratimi i kërkesave për subvencionim të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore dhe brenda fushëveprimit ligjor të komunës. Po ashtu, shtohet mbikëqyrja në procesin e vlerësimit të kërkesave, për të parandaluar miratimin e ndihmave në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ose për qëllime që tejkalojnë kompetencat e komunës.	Kryetari, Drejtoritë dhe Zyrat që menaxhojnë buxhetin nga kategoria e subvencioneve do të sigurojnë kriteret e qarta për ndarje dhe shpalljet publike në përputhshmëri me rregulloren për subvencione, dhe do të sigurojnë mbikëqyrje në procesin e vlerësimit të kërkesave që përfutuesit do ti plotësojnë kushtet.	Nga 01.07.2025 dhe ne vazhdimësi	D.Arsimit, DKRS, SHP, DSHMS
7	Çështja A4 - Siguria e ekzekutimit të kontratës jo në afatin e duhur	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike të nënshkruhen vetëm atëherë kur kontraktuesi të ofrojë sigurinë e ekzekutimit në afatin e përcaktuar me dosje të tenderit.	Kryetari do të sigurojë që kontratat publike të nënshkruhen vetëm atëherë kur kontraktuesi të ofrojë sigurinë e ekzekutimit në afatin e përcaktuar me dosje të tenderit,	Nga 01.07.2025 dhe për të gjitha kontratat.	Drejtoria e Prokurimit

			ne te kundërtën proceset e kontraktimit do te përsëriten.		
8	Çështja A5 - Përqindje e ulët e inspektimit të pronave për tatimin në pronëpronave për tatimin në pronë	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Kryetari s'bashku me Menaxherin e Njesisë së Tatimit në Pronë do te jetë ne koordinim te plotë me stafin përgjegjes për verifikim e pronave sipas rregulloreve deri ne 20 % min brenda vitit.	31.12.2025 dhe ne vitet ne vijim.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa – Sektori i Tatimit në Pronë
9	Çështja B4 - Mos vlerësimi i performances së kontraktuesve përmes platformës e-prokurimi nga menaxherët e kontratave	Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë të menaxherëve, vendosin informatat rreth implementimit të projekteve dhe bëjnë vlerësimin e performances së kontraktuesve përmes modulit të menaxhimit të kontratave në platformën e-prokurimi.	Kryetari dhe Drejtoria e Prokurimit do të forcojnë kontrollin e brendshëm për menaxhimin e kontratave dhe Menaxheret e kontratave do te bëjnë vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit të menaxhimit të kontratave në platformën e-prokurimi.	I filluar si proces nga Qershori 2025 dhe do të implement omet ne vazhdimësi	Drejtoria e Prokurimit
10	Çështja A6 - Vonesa ne realizim të projekteve kapitale.	Kryetari duhet të forcojë kontrollin e brendshme në menaxhimin e kontratave në mënyrë që të sigurojë që kontratat publike realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve kontraktuale.	Kryetari dhe Njësia vartëse do te përcjellin realizimin dhe menaxhimin e kontratave sipas kushteve kontraktuale ne mënyre qe projektet kapitale te realizohen sipas specifikave dhe te përfundohen ne afat kohor sipas planifikimit-kontratës	Nga 01.07.2025 dhe ne vazhdimësi per te gjitha kontratat	Drejtoria e Urbanizmit dhe e Sherbimeve Publike
11	Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.	Kryetari s'bashku me Menaxheret e Njësive do te ndërmerr masa ne realizimin e të hyrave komunale sipas rregulloreve ne fuqi.	01.07.2025	DGJKP dhe Njësiti tjera qe realizojn të hyrave komunale



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opstina Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-1 10-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, Kryetari i Komunës së Skenderajt z.Fadil Nura i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e rregullt të datës _____ 2025, të miratojë këtë:

PROPOZIM

- I.** Për miratimin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Nr.01-110/01-0025382/22, dt. 06.06.2022.
- II.** Draft Rregullorja cekur në pikën I të këtij propozimi është punuar në mënyrë profesionale nga komisioni i emëruar me Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-020/01-0026288/25, të datës 04.07.2025.
- III.** Drafti i cekur në pikën I ka kaluar procedurat e diskutimit publik, në bazë të udhëzimeve përkatëse për dhënien në diskutim publik të akteve komunale.
- IV.** Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bashkëngjitur: Drafti i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kuvendit të Komunës

Kryetari i Komunës

Fadil Nura





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES NR.01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ**

Skenderaj, 2025

Në mbështetje të nenit 11 dhe 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 2, paragrafin 3, nenin 8, nenin 13, 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L -108 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenin 20 dhe 61 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: _____ miraton këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 01-110/01-0025382/22 PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01-110/01-0025382/22, të datës 06.06.2022 Për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba të Komunës së Skenderajt.

Neni 2

2.1 Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 7 i nenit 5 të rregullores bazë, i cili formulohet si në vijim:

2.2 Nga taksa për automjete lirohen **familjet e dëshmorëve (familja e ngushtë), familjet e viktimave civile (familja e ngushtë), invalidët e luftës (personalisht), veteranët e luftës (personalisht)** dhe personat me aftësi të kufizuara (**personalisht**).

2.3 Në familjet e ngushta përfshihen: **Prindërit, bashkëshorti ose bashkëshortja, dhe fëmijët.**

2.4 Lirimi bëhet në bazë të prezantimit të dëshmisë (dokumenti bëhet fotokopje dhe i bashkëngjitet kërkesës) dhe në këto raste zyrtari për pagesa lëshon fletë-pagesa me vlerën zero (0), duke i'a bashkëngjitur dëshminë.

Neni 3

Hyrja në fuqi


Kjo Rregullore hyn në fuqi tridhjetë (30) pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe brenda shtatë (7) ditësh pas publikimit në web-faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.

Kryesuesja e Kuvendit

Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës 03.12.2008, ndërlidhur me Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

- I. **Formohet grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, në këtë përbërje:**
 1. **Besnik Smakaj**, kryesues
 2. **Amir Lushtaku**, anëtar
 3. **Ilmi Kabashi**, anëtar
 4. **Antigona Maliqi**, anëtare
 5. **Dafina Shala**, anëtare
- II. **Detyrë e grupit punues nga pika I e këtij vendimi, është zbatimi i procedurave për ndryshimin dhe plotësimin Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba, konform legjislacionit në fuqi.**
- III. **Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.**

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesuesit të grupit punues
- Anëtarëve të grupit punues





Republika e Kosovës
Skenderaj Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 02-060/01-0026290/25
Data 04.07.2025



Kuvendi i Komunës
Opstina Skenderaj
Municipality of Assembly

Bazuar në ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt Nr. 110-385, neneve 28 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna (MAPL), Komuna e Skenderajt lëshon këtë:

Njoftim publik

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 04.07.2025 deri me datën 21.07.2025 ndërsa diskutimi publik me qytetarë do të mbahet me datë 14.07.2025, në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar nga ora 14:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën 21.07.2025 në ora 16:00, në emailat e zyrtarëve: besnik.smakaj@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net.

Për më shumë detaje plotësim-ndryshimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba nr. 01-110/01-0025382/22 mund të vizitoni vegëzën e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Rregullore-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-rregullores-per-taksa-tarifa-ngarkesa-dhe-gjoba-1.pdf>

Amir Lushtaku

Udhëheqës për Komunikim me Publikun





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr. 02-351/04-0026564/25
Data 10.07.2025



Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58, shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës. 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 17, parag. 3.2 dhe nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë _____, të miratojnë këtë:


PROPOZIM

- I. Miratimin e vendimit për themelimin e poliklinikës specialiste në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt.
- II. Poliklinika Specialiste do të themelohet si institucion i kujdesit dytësor shëndetësor, me qëllim të plotësimit të mungesave ekzistuese në ofrimin e shërbimeve.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesuses së KK-së





Drejtoria për Shëndetësi

Direkcija za zdravstvo

Department of Health

DATË/A:	07/07/2025
PËR/ZA/TO:	Z. Fadil Nura Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Z. Ilir Havolli U.D Drejtor në QKMF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për iniciimin e themelimit të Poliklinikës Specialistike Publike në Komunën e Skenderajt

I nderuar Kryetar,

Duke marrë parasysh nevojat e mëdha për shërbime shëndetësore të nivelit dytësor në Komunën e Skenderajt dhe kufizimet aktuale në ofrimin e konsultave Specialistike brenda sistemit ekzistues të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH), ju drejtohem me këtë kërkesë për iniciimin e procedurave për themelimin e një **Poliklinike Specialistike Publike**.

Arsyetimi i Kërkesës:

- Kërkesat për shërbime specialistike janë në rritje të vazhdueshme, duke tejkaluar kapacitetet e KPSH-së.
- Numri i specialistëve në Kosovë është në rritje, por mundësia e punësimit të tyre brenda institucioneve publike mbetet e kufizuar.
- Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125, Neni 17, pika 3.2 përcakton **Poliklinikën Specialistike** si institucion të nivelit dytësor, i cili mund të organizohet për të plotësuar boshllëqet ekzistuese në ofrimin e shërbimeve.
- Udhëzimi Administrativ për Kujdesin Parësor Shëndetësor (UA 04/2020) kufizon ofrimin e shërbimeve specialistike brenda KPSH-së, duke e bërë të domosdoshëm një institucion të dedikuar për këtë qëllim.

Kërkesa:

Duke marrë parasysh këto fakte, kërkoj nga Drejtoria për Shëndetësi në Komunën e Skenderajt që të ndërmarrë hapat e nevojshëm për iniciimin e themelimit të Poliklinikës Specialistike Publike.

Konkretisht, kërkoj:

1. Shqyrtimin dhe miratimin e kësaj nisme nga ana e Drejtorisë për Shëndetësi.
2. Ngritjen e çështjes për diskutim dhe miratim në instancat përkatëse -Asamblenë Komunale të Komunës së Skenderajt.
3. Hartimin, **përgatitjen e dokumentacionit zyrtar** dhe dërgimin e kërkesës zyrtare për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë.

Me besimin se kjo nismë do të sjellë përmirësime të ndjeshme në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Komunës së Skenderajt, pres përgjigjen tuaj dhe mbështetjen në këtë proces.

Me respekt,
Ilir HAVOLLI
U.D. Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare
Komuna e Skenderajt
26.02.2025



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 02-052/01-0027799/25
Data 11-07-2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, konform Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, dhe nenin 50,1 nën h) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.110-385, dt.03.12.2008, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullt të datës: __. __.2025, Kryetari i Komunës i :

PROPOZON

- I. Miratimin e Raportit Përfundimtar Nr.09-052/01-0026407/25, të datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (era, zjarri etj.) për periudhën Janar – Qershor, të cilat janë shkaktuar në bujqësi dhe në ekonomi familjare në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej **217, 481.49 Euro**.
- II. Raporti i dëmeve i cekur në pikën një, i shqyrtuar nga Kryetari i Komunës përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të komisionit paraprak të emëruar nga Kryetari i Komunës dhe kërkesave për kompensim të dëmeve nga qytetarët (familjet) e dëmtuara nga erërat, dhe zjarri etj., të cekura në pikën një, dhe i njëjti raport pas miratimit në Kuvendin Komunal në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Bashkëngjitur: Raporti nr.09-052/01-0026407/25, të datës 07.07.2025, Lista e fërmerëve të vlerësuar, dhe vendimi bazë i komisionit komunal nr.02-020/01-0030478/23, dt. 21.06.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin nr.02-020/01-0034210/23, dt.12.07.2023, Vendimin nr.02-020/01-0043987/24, dt. 09.09.2024, si dhe Vendimin nr. 02-020/01-0011682/25, dt. 28.03.2025.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës

Padil Nura



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPSTINA
SKENDERAJ

Nr. 09-052/04-0026407/25
Data 07.07.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Shërbime Publike
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services

DATE/A:	03.07.2025
PËR/ZA/TO:	Zyrën Ligjore, Kuvendin Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtori i Shërbimeve Publike - Alban Shala
NGA/OD/FROM:	Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera: 1. Faton Osmani Kryesues 2. Dardan Smajli Anëtar 3. Sabit Ferizi Anëtar 4. Leonard Kahrmani Anëtar 5. Hajzer Shala Anëtar
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport përfundimtar i komisionit për vlerësimin e dëmeve, Janar – Qershor 2025

Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive tjera, sipas rregullores (15/2017) të Metodologjisë së vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe në bazë të kërkesave të palëve të dëmtuara, pas përfundimit të vlerësimeve, komisioni ka hartuar raportin përfundimtar në të cilin kanë konstatuar vlerën e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga zjarret, era, breshëri, ngricat dhe fatkeqësitë tjera për muajt Janar - Qershor 2025.

Pas përfundimit të vlerësimeve, komisioni ka bërë raportin përfundimtar, në të cilin raport i ka konstatuar dëmet në bujqësi dhe ekonomi familjare në tabelën në vijim:

Nr.	Kategoria	Nr. i rasteve	Vlera €
1.	Dëmet në Bujqësi:	36	140,777.84 €
2.	Dëmet në Ekonomi Familjare:	6	76,703.65 €
	TOTALI I DËMEVE:		217,481.49 €

Vlerësimin e dëmeve e zbatojnë drejtpërsëdrejti në zonën në të cilin kanë ndodhur dëmet, duke bërë grumbullimin e të dhënave lidhur me dëmet materiale dhe dokumentimin me fotografi. Përcaktimi i vlerës

së dëmeve në të mirat materiale të dëmtuara dhe shkatërruara bëhet në bazë të çmimeve përkatëse. Çmimet sigurohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, e cila bën përcjelljen e çmimeve, po ashtu çmimet nga tregu, çmime nga ndërmarrjet që bëjnë furnizime të tilla.

Andaj propozoj që ky raport të hyjë në pike e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal për miratim. Lista e përmbledhur e vlerësimit të dëmeve, pas miratimit nga Asambleja Komonale e Skenderajt do të dërgohet në Komisionin Qeveritar (AME) për vlerësimin e dëmeve të gjashtë mujorit të parë Janar – Qershor të vitit 2025.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Lista e fermerëve të vlerësuar nga Komisioni Komunal për demet e te shkaktura nga zjarri/ariu ne ekonomi familjare për vitin 2025

NR

NR	Emri dhe Mbiemri	Fshati	Komuna	Nr. Personal	Nr. I llogarisë bankare	Emri i bankës	Periudha e muajit (dëmi)	Shkaku i dëmtimit	Totali në euro sipas raportit nga Komuna
1	Muharrem Brahimi	Plluzhin	Skenderaj	1002235893	1405000055179787	BE	Qershor	Zjarri	12,052.27
2	Osman Bytyqi	Abri e poshte	Skenderaj	1002236768	2022000022456348	TEB	Majë	Zjarri	54,733.90
3	Isa Qitaku	Leqin	Skenderaj	2021551557	2022000038533225	TEB	Mars	Zjarri	6,708.20
4	Ferat Sinani	Ternaft	Skenderaj	1005244800	2022000185655356	TEB	Majë	Ariu	2,500.00
5	Bislim Haliti	Buroj	Skenderaj	1001804754	1707003029867276	NLB	Qershor	Zjarri	451.36
6	Fadil Haliti	Buroj	Skenderaj	2001746297			Qershor	Zjarri	257.92
	TOTAL								76,703.65

Anëtarët e komisionit:

Faton Osmani
Dardan Smajli
Sabit Ferizi

Leonard Kahrmani
Hajzer Shala





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Lista e fermerëve të vlerësuar nga Komisioni Komunal për demet e te shkaktura nga era/ngricat për vitin 2025

JR

JR	Emri dhe Mbiemri	Fshati	Komuna	Nr. Personal	Nr. I llogarisë bankare	Emri i bankës	Periudha e muajit (dëmi)	Shkaku i dëmtimit	Totali në euro sipas raportit nga Komuna
1	Albana Hysenaj	Izbic	Skenderaj	1244044383	2011000193274868	TEB	Mars	Era	939.12
2	Ajshe Beqiri	Dashec	Skenderaj	2003014447	1707003031720849	NLB	Prill	Ngricat	14,100.17
3	Artan Qitaku	Qitak	Skenderaj	1004408221	1303003014685830	BPB	Prill	Ngricat	12,411.97
4	Behar Dragaj	Leqin	Skenderaj	1231469156	1953002872021135	BKT	Mars	Era	187.82
5	Bexhet Vojvoda	Llaush	Skenderaj	1232284648	1305003700934734	BPB	Mars	Era	1,620.00
6	Qamil Kahrmani	Baks	Skenderaj	1230933657	2021000081727278	TEB	Prill	Ngricat	7,123.08
7	Drilon Isufi	Kopiliq I poshtem	Skenderaj	1242793958	2011000210203987	TEB	Mars	Era	187.82
8	Dardan Geci	Skenderaj	Skenderaj	1030542556			Mars	Era	750.00
9	Driton Shala	Buroj	Skenderaj	1500872221	1707018604127233	NLB	Mars	Era	2,817.36
10	Edison Ramadani	Buroj	Skenderaj	1250427251	1707018604968029	NLB	Mars	Era	2,970.00
11	Emine Lushtaku	Prekaz I poshtem	Skenderaj	1242697177	1701010400758090	NLB	Mars	Era	2,253.89
12	Elvira Bajraktari	Klin e eperme	Skenderaj	1243649508	2022000150732834	TEB	Mars	Era	563.47
13	Fahri Osmani	Vajnik	Skenderaj	1030655156	1401000011952616	BE	Mars	Era	14,650.27
14	Fehmi Biliqi	Qubrel	Skenderaj	1005831110	1707003020085020	NLB	Mars	Era	187.82
15	Ferdane Muharremi	Qubrel	Skenderaj	1004077411			Mars	Era	187.82
16	Fadil Berisha	Turqec	Skenderaj	1003976684	2022000189808217	TEB	Mars	Era	675.00
17	Fidan Xhemajli	Runik	Skenderaj	1176442871	1707018603875324	NLB	Mars	Era	1,200.00
18	Murat Vojvoda	Llaush	Skenderaj	2005812367	1953002278021168	BKT	Mars	Era	675.00
19	Majlinda Zyhrani	Llaush	Skenderaj	1174948831	1903480429321111	BKT	Mars	Era	3,756.48
20	Milazim Lushtaku	Prekaz I poshtem	Skenderaj	1030989895	1161665569000105	PCB	Prill	Ngricat	45,226.57
21	Nexhat Sugogertaj	Qubrel	Skenderaj	1005831659	1701018501252437	NLB	Mars	Era	2,441.71
22	Imer Januzi	Qitak	Skenderaj	1004407667	1303003011674950	BPB	Prill	Ngricat	4,340.43
23	Ismet Kadriu	Likoc	Skenderaj	1500266534	2022000184623276	TEB	Mars	Ngricat	957.94
24	Jeton Isufi	Krasmirovic	Skenderaj	11746918784	1707018602231659	NLB	Mars	Era	187.82
25	Jashar Durmishi	Rakinic	Skenderaj	1005838084	1707003020085311	NLB	Prill	Ngricat	10,409.63
26	Kadri Halitaj	Kosterc	Skenderaj	1005257391	1503050001146321	RFB	Mars	Era	1,200.00
27	Halil Thaqi	Buroj	Skenderaj	1008370822	1503050000761425	RFB	Mars	Era	469.56
28	Halil Hysenaj	Izbic	Skenderaj	2005256367	1503050001680694	RFB	Mars	Era	1,500.00
29	Hysen Dajaku	Rakinic	Skenderaj	1003907950	1305003011040179	BPB	Mars	Era	187.82
30	Iendita Sylanaj	Llaush	Skenderaj	1008624956	1707003030161477	NLB	Mars	Era	2,441.71
31	Lulzim Hasani	Turqec	Skenderaj	20048228227	1160633142000162	PCB	Mars	Era	375.65
32	Luljeta Musliu	Prekaz I Eperme	Skenderaj	1005812476			Mars	Era	187.82
33	Labinot Fekaj	Qubrel	Skenderaj	1242737411			Mars	Era	187.82
34	Sejdi Shaqiri	Tushil	Skenderaj	1005412559			Mars	Era	187.82
35	Sadri Prokshi	Leqin	Skenderaj	1005250621	2022000059358252	TEB	Prill	Ngricat	3,030.63
36	Shemsije Jashari	Prekaz I poshtem	Skenderaj	1021292822	1300003012664791	BPB	Mars	Era	187.82
Totali €									140,777.84


Anëtarët e komisionit:

- 1 Faton Osmani
- 2 Dardan Smajli
- 3 Sabit Ferizi
- 4 Leonard Kahrmani
- 5 Hajzer Shala





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Precednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Nr.110-385 të datës 03.12.2008, nenin 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, dhe sipas kërkesës së DSHP-së Nr.09-020/01-0030073/23 të datës 19.06.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
(Për formimin e komisionit)

1. **Formohet komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në Komunën e Skenderajt, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Imer Salihu-DSHP, kryesues
 - 1.2 Adem Muharremi-DUMA, anëtar
 - 1.3 Sabit Ferizi-DBPZHR, anëtar
 - 1.4 Albert Rexhepi-DBF, anëtar
 - 1.5 Faton Osmani-DSHP, anëtar
2. Detyrat e komisionit të lartcekur janë të përcaktuara në nenin 12 dhe 14 të Rregullores Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.
3. Mandati i komisionit të lartcekur është 4 (katër) vjeçar.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi në bazë të dispozitave të nenit 53, nenit 57 paragrafi 1, nenit 58 paragrafi 2, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, shfuqizohet vendimi Nr.02-020/01-0010902/23 të datës 02.03.2023 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës për po të njejtën çështje dhe si i tillë nuk prodhon efekte juridike në të ardhmën.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DSHP-së
- Anëtarëve të komisionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Nr.110-385 të datës 03.12.2008, nenin 53 parag. 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe sipas kërkesës të zyrtarit z.Adem Muharremi Nr.06-020/01-0033278/23 të datës 07.07.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit Nr.02-020/01-0030478/23 të datës 21.06.2023 mbi formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në Komunë e Skenderajt.
- II. Në nenin 1 pika 1.2 të vendimit të lartcekur, ndërrohet anëtari Adem Muharremi dhe zëvendësohet me anëtarin **Zenë Rushiti**.
- III. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr.02-020/01-0030478/23 të datës 21.06.2023, ndërsa pjesët tjera mbeten në fuqi dhe të pandryshuara.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DSHP-së
- Zyrtarëve



Kryetari i Komunës

Fadil Nura
Fadil Nura



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

02-020/01-0043987/24
09.09.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt, Nr.110-385 të datës 03.12.2008, nenin 58 paragraf. 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe pas shqyrtimit të kërkesës nr.09-325/04-0043623/24 të datës 05.09.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim miratohet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit Nr.02-020/01-0030478/23 të datës 21.06.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin nr.02-020/01-0034210/23 të datës 12.07.2023 mbi formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në Komunën e Skenderajt.
2. Komisioni i lartcekur do të këtë përbërje si në vijim:
 - 2.1 Faton Osmani - DSHP, kryesues
 - 2.2 Zenë Rushiti - DIK, anëtar
 - 2.3 Sabit Ferizi - DBPZHR, anëtar
 - 2.4 Leonard Kahrmani - DBF, anëtar
 - 2.5 Hajzer Shala - DSHP, anëtar
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr.02-020/01-0030478/23 të datës 21.06.2023 dhe vendimit 02-020/01-0034210/23 të datës 12.07.2023, pjesët tjera mbesin në fuqi dhe të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DSHP-së
- Anëtarëve

Kryetari i Komunës

Fadil Nura



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.

No 02-020/01-0043987/24

Data

Data 28.03.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, nenit 53 parag.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas vendimit bazë nr.02-020/01-0030478/23 të datës 21.06.2023, pas shqyrtimit të kërkesës së DSHP-së Nr.09-325/04-0011290/25 të datës 26.03.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

1. **Plotësohet dhe Ndryshohet** Vendimi nr.02-020/01-0043987/24 të datës 09.09.2024 për vlerësimin e dëmeve si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në Komunën e Skenderajt.
2. Në pikën 2.2 të vendimit të lartcekur anëtari Zenë Rushiti për shkak të pensionimit **zëvendësohet me zyrtarin Dardan Smajli (anëtar i komisionit).**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Arkivit
- DSHP-së
- z.Faton Osmani
- z.Dardan Smajli

Kryetari i Komunës


Fadil Nura

Pyetjet dhe kërkesat e anëtareve për ekzekutivin e Komunës, Korrik 2025

1. **Pyetje për Kryetarin z. Fadil Nura:** Z. Nura, a keni mundësi të na informoni se çfarë është duke ndodhur me procesin e kompensimit apo pagesave për dëmet e shkaktuara në vetura nga vërshimet? A është ndërmarrë ndonjë hap konkret nga komuna apo institucionet përkatëse për t'i ndihmuar qytetarët që janë prekur nga këto dëme?
2. Z. Nura, A mund të na sqaroni pse gjatë mandatit të qeverisjes suaj nuk është realizuar asnjë projekt i ujit të pijshëm, kanalizimit apo ndriçimit publik në fshatin Kryshec – Marine, si dhe në shumë fshatra të tjerë të komunës? Banorët e këtyre zonave vazhdojnë të përballen me kushte të rënda jetese, ndërsa mungesa e këtyre shërbimeve bazike është një shqetësim serioz për ta.
3. **Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit, z. Driton Mula;** I nderuar Drejtor, Rruga “Hasan Feka” në fshatin Llaushë është e shtruar vetëm me zhavorr dhe gjendja e saj po shkakton shumë vështirësi për banorët, sidomos për shkak të pluhurit të madh gjatë muajve të verës. A keni në plan që kjo rrugë të përfshihet në projektet e asfaltimit në të ardhmen e afërt? Banorët kanë nevojë të madhe që kjo rrugë të rregullohet sa më parë.

Abdulla Gashi-IDEAL
